CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Manual

për Përmirësimin e Transparencës në Gjykata

Nëntor, 2025

Manual
për Përmirësimin e Transparencës së Gjykatave

Nëntor, 2025

Funded by the European Union
IPLS institute for policy & legal studies
OPEN SOCIETY FOUNDATIONS WESTERN BALKANS
Centre for Legal Empowerment
CSDG Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes

Ky manual është përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në kuadër të projektit **"Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies në gjykata: Një vlerësim i përputhshmërisë me standardet e transparencës",** i cili zbatohet si pjesë e një sub-granti në kuadër të projektit "Judiciary under Spotlight", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij manuali është përgjegjësi e vetme e CSDG-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian apo të projektit "Judiciary under Spotlight".

Ky manual mbështetet në parimin se transparenca gjyqësore mund të përmirësohet nëse ekzistojnë kushtet e duhura institucionale, organizative dhe kulturore për zbatimin e saj. Ai presupozon një sistem gjyqësor funksional, ku çdo gjykatë disponon struktura të qarta administrative, burime njerëzore të mjaftueshme dhe mjete teknologjike që mundësojnë publikimin, përditësimin dhe komunikimin efektiv të informacionit publik.

Në këtë kuptim, manuali ndërtohet mbi një bazë të qëndrueshme organizative, ku transparenca shihet si pjesë përbërëse e funksionimit të përditshëm institucional. Zbatimi i udhëzimeve dhe standardeve të paraqitura kërkon një kulturë bashkëpunimi, përfshirjeje dhe përmirësimi të vazhdueshëm, si në nivel të gjykatave, ashtu edhe të institucioneve mbështetëse të sistemit.

Ky manual synon të orientojë, jo të imponojë; të ndihmojë institucionet të ndërtojnë kapacitete, të unifikojnë praktikat dhe të konsolidojnë një transparencë funksionale, të kuptueshme dhe të qëndrueshme për publikun.

Tabela e **Përmbajtjes**

- Hyrje
- Qëllimi i Manualit
- Metodologjia dhe burimi i gjetjeve
- Koordinimi institucional dhe rolet administrative
- Standardizimi dhe cilësia e publikimeve
- Transparenca aktive përkundrejt transparencës pasive
- Teknologjia dhe automatizimi i proceseve
- Komunikimi me publikun dhe median
- Kultura institucionale e transparencës
- Transparenca në vendimmarrjen gjyqësore dhe aksesi në vendime
- Transparenca statistikore dhe të dhënat mbi performancën
- Shërbimet për publikun dhe aksesueshmëria
- Monitorimi, vlerësimi dhe reagimi nga publiku
- Programet e transparencës dhe zbatimi në praktikë
- Organizimi dhe funksionaliteti i faqes zyrtare të gjykatës

Hyrje

Transparenca është një nga shtyllat themelore mbi të cilat mbështetet legjitimiteti i sistemit gjyqësor dhe besimi i qytetarëve tek drejtësia. Në një shoqëri demokratike, gjykatat nuk janë thjesht institucione që zbatojnë ligjin, por edhe garantë të përgjegjshmërisë publike. Hapja, qartësia dhe komunikimi i rregullt me publikun janë parakushte për ndërtimin e një drejtësie të kuptueshme, të besueshme dhe të afërt me qytetarin.

Ky Manual për Transparencën Online të Gjykatave në Shqipëri (2025) është hartuar me qëllimin për të ndihmuar gjykatat, Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe aktorët mbështetës të sistemit të drejtësisë në zhvillimin e një qasjeje të unifikuar, funksionale dhe të qëndrueshme ndaj transparencës.

Dokumenti bazohet në rezultatet e pyetësorit "Vlerësimi i praktikave të transparencës në gjykata (2025)" dhe të Scorecard-it për Transparencën Online të Gjykatave (2025). Këto burime kanë mundësuar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale të transparencës në sistemin gjyqësor, duke evidentuar si aspektet pozitive, ashtu edhe boshllëqet strukturore që kërkojnë ndërhyrje.

Manuali është ndërtuar mbi parimin se transparenca nuk është vetëm detyrim ligjor, por kulturë institucionale që duhet ndërtuar, ushqyer dhe matur në mënyrë të vazhdueshme. Ai synon të kalojë nga matja formale në udhëzimin praktik, duke ofruar mjete për:

- rritjen e koherencës ndërmjet gjykatave;
- standardizimin e formateve dhe procedurave;
- përdorimin e teknologjisë dhe automatizimit në publikime;
- forcimin e komunikimit me publikun dhe median;
- integrimin e përshtypjeve në përmirësimin institucional.

Nëpërmjet **12 tematikave kryesore**, manuali trajton të gjitha dimensionet e transparencës, nga koordinimi administrativ e teknologjik, deri te kultura e hapjes, qasja në vendime, statistikat e performancës dhe mekanizmat e monitorimit publik. Secila tematikë përfshin një analizë të bazuar në evidenca dhe një paketë rekomandimesh orientuese, të përgatitura për t'u përdorur si udhërrëfyes praktik në nivel gjykate apo përtej.

Ky manual synon të shërbejë si dokument referimi për gjykatat, politikat e KLGJ-së, projektet donatore dhe organizatat e shoqërisë civile që mbështesin forcimin e llogaridhënies gjyqësore. Ai është menduar si instrument pune i hapur, që mund të përditësohet në vijimësi në përputhje me zhvillimet teknologjike, ligjore dhe institucionale, duke ndihmuar sistemin gjyqësor shqiptar të ecë drejt një transparence të matshme, të besueshme dhe të koordinuar.

Qëllimi i Manualit

Ky manual synon të shërbejë si një udhërrëfyes praktik për forcimin e transparencës gjyqësore në Shqipëri, duke e shndërruar atë nga një proces formal në një funksion institucional të integruar dhe të matshëm. Ai nuk ka karakter thjesht përshkrues, por synon të ofrojë disa alternativa konkrete të problematikave të identifikuara në praktikën e përditshme të gjykatave dhe në bashkëveprimin e tyre me aktorë të tjerë.

Manuali është ndërtuar bazuar në evidenca dhe të dhëna nga praktika e gjykatave. Çdo analizë dhe udhëzim burojnë nga të dhëna reale të mbledhura përmes pyetësorit të vitit 2025, scorecard-it të transparencës online dhe dokumenteve institucionale të referuar. Në këtë mënyrë, ai ofron rekomandime të verifikueshme, të mbështetura në prova dhe jo në perceptime.

Dokumenti është gjithashtu i orientuar nga zgjidhja. Pëveç identifikimit të mangësive, ai ofron udhëzime të zbatueshme hap-pas-hapi, të ndara sipas tematikave kryesore të transparencës: koordinimi institucional, standardizimi i publikimeve, transparenca aktive dhe pasive, teknologjia dhe automatizimi, kultura institucionale, aksesi në vendime, transparenca statistikore dhe mekanizmat e monitorimit publik. Për secilën fushë, manuali përmbledh probleme, pasoja dhe zgjidhje, duke u shërbyer gjykatave si instrument për përmirësim gradual dhe të qëndrueshëm.

Një tjetër qëllim thelbësor është unifikimi i qasjes ndërmjet gjykatave. Manuali propozon standarde të përbashkëta për formatet, afatet, strukturën dhe mënyrën e publikimit të informacionit, duke synuar të reduktojë pabarazitë ekzistuese dhe të krijojë një model kombëtar të transparencës gjyqësore. Në këtë mënyrë, ai i ndihmon gjykatat të harmonizojnë praktikat e tyre me udhëzimet e KLGJ-së dhe me standardet evropiane të llogaridhënies.

Së fundi, manuali synon të ketë vlerë të qëndrueshme institucionale. Ai është konceptuar si dokument referimi për KLGJ-në, gjykatat, institucionet partnere dhe projektet donatore, që mund të përdoret për:

- trajnime dhe orientim të stafit;
- zhvillim të planeve vjetore të transparencës;
- integrim të treguesve të matjes në sistemet ekzistuese të raportimit;
- dhe si bazë për rishikime periodike të politikave të hapjes gjyqësore.

Në këtë kuptim, manuali përfaqëson një mjet të qëndrueshëm zhvillimi institucional, që bashkon dimensionin ligjor, teknologjik dhe kulturor të transparencës, duke e kthyer atë në pjesë të pandashme të identitetit të drejtësisë shqiptare.

Metodologjia dhe burimi i gjetjeve

Ky manual është ndërtuar mbi një qasje metodologjike të kombinuar, që ndërthur analizën ligjore, shqyrtimin institucional dhe mbledhjen e të dhënave empirike nga vetë gjykatat shqiptare.

Qëllimi ka qenë të sigurohet që çdo përfundim dhe rekomandim të jetë i verifikueshëm, i matshëm dhe i lidhur drejtpërdrejt me praktikën aktuale të transparencës.

1. Burimet kryesore të të dhënave

Përgatitja e manualit është mbështetur në tre burime themelore të informacionit:

- Pyetësori "Vlerësimi i praktikave të transparencës në gjykata (2025)", i zhvilluar me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të koordinatorëve për të drejtën e informimit, specialistëve të IT-së dhe zyrtarëve të marrëdhënieve me publikun në të gjitha kategoritë e gjykatave. Pyetësori ka synuar të evidentojë praktikat ekzistuese të publikimit, mënyrën e administrimit të kërkesave për informacion, rolet e stafit dhe sfidat në zbatimin e detyrimeve ligjore të transparencës.

- Scorecard-i "Transparenca online e gjykatave në Shqipëri (2025)", i cili ka shërbyer si instrument matës për vlerësimin e përmbajtjes, përditësimit dhe cilësisë së publikimeve në faqet zyrtare të gjykatave. Ky instrument ka mundësuar një vlerësim të krahasuar ndërmjet institucioneve dhe ka identifikuar boshllëqet strukturore në përmbushjen e detyrimeve të transparencës aktive.

- Dokumentet dhe raportet zyrtare institucionale të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), gjykatave dhe partnerëve institucionalë për periudhën 2020–2024, përfshirë raportet vjetore të veprimtarisë, planet e transparencës, auditimet dhe raportet buxhetore. Këto dokumente kanë ndihmuar në verifikimin e gjetjeve empirike dhe në ndërtimin e një panorame të balancuar mes kuadrit normativ dhe praktikës së zbatimit.

Metodologjia dhe burimi i gjetjeve

2. Qasja metodologjike

Metodologjia e ndjekur është analitike, krahasuese dhe orientuar drejt zgjidhjes. Ajo përfshin tre faza të ndërlidhura:

- **Analiza ligjore dhe institucionale:** rishikim i kuadrit ligjor dhe nënligjor që përcakton detyrimet e transparencës së gjykatave, duke identifikuar boshllëqet e harmonizimit ndërmjet ligjit, rregulloreve dhe praktikës reale.
- **Analiza empirike e të dhënave të mbledhura:** përpunim dhe interpretim i rezultateve nga pyetësori dhe scorecard-i, me qëllim nxjerrjen e trendeve, dobësive të përsëritura dhe modeleve pozitive të aplikueshme.
- **Hartimi i udhëzimeve praktike:** përkthimi i gjetjeve në zgjidhje konkrete dhe të zbatueshme, të strukturuara sipas tematikave kyçe të manualit.

3. Parimet udhëheqëse të analizës

Gjatë gjithë procesit, analiza është udhëhequr nga tre parime metodologjike bazë:

- **Bazimi në evidencë (evidence-based approach):** çdo gjetje dhe rekomandim buron nga të dhëna reale dhe dokumente zyrtare.
- **Koherenca dhe krahasueshmëria:** rezultatet janë të ndërtuara mbi kritere të njëjta për të gjitha gjykatat, duke mundësuar vlerësim të drejtë dhe uniform.
- **Qasja praktike dhe zgjidhëse:** çdo tematikë përfshin problematikën dhe zgjidhjen, duke u fokusuar në zbatueshmëri dhe ndikim afatgjatë.

4. Kufizimet metodologjike

Në disa raste, mungesa e të dhënave të plota ose e publikimeve të vazhdueshme nga gjykatat ka kufizuar mundësinë për analizë të thelluar krahasuese ndërvite. Megjithatë, kombinimi i burimeve zyrtare, të dhënave të mbledhura drejtpërdrejt dhe vlerësimeve cilësore ka siguruar një kuadër të besueshëm dhe të verifikueshëm të gjetjeve, që reflekton realitetin aktual të transparencës gjyqësore në Shqipëri.

Në përfundim, kjo metodologji garanton që manuali të jetë produkt i verifikuar empirikisht, me bazë të fortë faktike dhe me qëllim për t'u përdorur si instrument i qëndrueshëm për planifikim, vetëvlerësim dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional.

KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE ROLET ADMINISTRATIVE

Koordinimi institucional dhe rolet administrative

Përmbajtja dhe rëndësia

Transparenca gjyqësore nuk varet vetëm nga aktet e miratuara apo publikimi i dokumenteve, por ndjeshëm edhe nga niveli i koordinimit të brendshëm institucional ndërmjet strukturave përgjegjëse për zbatimin e saj.

Në nivel gjykate, zbatimi efektiv i transparencës kërkon një ekosistem të qartë bashkëveprimi ndërmjet aktorëve kyç: kryetarit të gjykatës, kancelarit, koordinatorit për të drejtën e informimit, nëpunësit për marrëdhëniet me publikun, specialistit të IT-së dhe, në shumë raste, sekretarisë gjyqësore.

Mungesa e përcaktimit të qartë të përgjegjësive dhe e bashkëpunimit ndërmjet këtyre roleve shpie në humbje koherence, qëndrueshmërie dhe ndikimi real të mekanizmave të transparencës ndaj publikut.

1. Mungesë e ndarjes së qartë të roleve dhe përgjegjësive

Në shumë raste, përgjegjësitë që lidhen me transparencën gjyqësore janë të shpërndara ndërmjet strukturave të ndryshme administrative, pa përcaktim të qartë të funksioneve dhe pa një vijë të unifikuar orientimi.

Kjo shpërndarje jo e rregulluar sjell mbivendosje kompetencash, boshllëqe në proces dhe vështirësi në koordinim, duke ndikuar negativisht në cilësinë e informacionit që publikohet dhe në kohën e përpunimit të kërkesave të publikut.

Këto problematika pasqyrojnë mungesën e një rregulloreje të brendshme të standardizuar, e cila do të përcaktonte:

- detyrat dhe rolet e çdo njësie që kontribuon në procesin e transparencës;
- mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet njësive të ndryshme administrative;
- afatet dhe standardet për publikimin e informacionit online, si dhe kontrollin e cilësisë së tij.

2. Varësi nga struktura administrative dhe mungesë autoriteti funksional

Shpesh, pozicionet që lidhen me koordinatorin për të drejtën e informimit ose zyrtari i PR-it uk e gëzojnë një pozitë funksionale që u lejon të marrin vendime të pavarura mbi publikimin e informacionit.

Ata varen hierarkikisht nga kancelari ose një drejtues administrativ, duke krijuar burokraci dhe vonesa në procesin e publikimit. Kjo varësi e bën transparencën të perceptohet si një detyrë sekondare, më shumë administrative sesa funksion publik me prioritet të lartë.

Gjithashtu, mungon një linjë e qartë përgjegjësie vertikale që do të lidhte strukturat e transparencës në gjykata me një mekanizëm qendror të mbikëqyrjes dhe asistencës (p.sh. KLGJ), për të garantuar standardizim, mbështetje metodologjike dhe monitorim të unifikuar të praktikave të transparencës.

Koordinimi institucional dhe rolet administrative

3. Komunikim i fragmentuar ndërmjet sektorëve të brendshëm

Një nga sfidat më të theksuara është mungesa e bashkërendimit efektiv ndërmjet sektorëve që kontribuojnë në zbatimin e transparencës. Njësitë përgjegjëse për aspektet juridike, teknike dhe komunikimit publik shpesh operojnë në mënyrë të pavarur, pa mekanizma të rregullt bashkëveprimi, pa takime periodike koordinuese dhe pa një kalendar të përbashkët pune.

Si rezultat, procesi i transparencës humbet koherencën: përmbajtja mund të jetë e saktë juridikisht, por jo e formatuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për publikun; ose informacioni mund të publikohet teknikisht në kohë, por pa kontekst, pa datë përditësimi dhe pa një narrativë komunikimi që e bën atë të aksesueshëm. Kjo fragmentarizim rrit rrezikun që transparenca të shfaqet si produkt i paunifikuar, me ritme të ndryshme dhe standarde të ndryshme brenda së njëjtës gjykatë.

4. Mungesë manualesh të brendshme për menaxhimin e transparencës

Shumica e gjykatave nuk disponojnë një manual të brendshëm apo udhëzues operativ që përcakton qartë procedurat e transparencës, rrjedhën e punës, përgjegjësitë e çdo strukture dhe standardet e publikimit të informacionit. Në mungesë të një dokumenti të standardizuar:

- punonjësit mbështeten kryesisht në përvojën individuale ose në praktika të trashëguara;
- përditësimi i informacionit online kryhet pa një kalendar të përcaktuar, duke lënë hapësira për mospërputhje;
- nuk ekzistojnë mekanizma të brendshëm për kontrollin e cilësisë dhe përmbajtjes së materialeve që publikohen.

Në disa institucione, këto boshllëqe janë adresuar përmes udhëzimeve të brendshme të përgatitura nga drejtuesit administrativë ose nga stafi, por këto zgjidhje nuk përbëjnë standard kombëtar dhe ndryshojnë ndjeshëm nga një gjykatë tek tjetra.

5. Roli i kufizuar i drejtuesit të gjykatës

Një tjetër problematikë lidhet me perceptimin e transparencës si funksion dytësor administrativ, më shumë sesa si komponent thelbësor i drejtimit institucional. Në shumë raste, drejtuesit e gjykatave nuk marrin rol aktiv në orientimin e politikave të transparencës, në monitorimin e zbatimit të tyre apo në komunikimin e gjykatës me publikun. Kjo qasje sjell:

- ulje të prioritetit institucional që i jepet transparencës;
- mungesë mbështetjeje të mjaftueshme për stafin përgjegjës;
- krijimin e perceptimit publik se gjykata është e mbyllur, jo proaktive dhe reaguese vetëm në raste të nevojës.

Në disa institucione, transparenca funksionon më tepër falë angazhimit individual të një punonjësi, sesa si rezultat i një kulture të konsoliduar dhe të drejtuar nga niveli më i lartë institucional.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Ngritja e kapaciteteve për bashkëpunim ndërsektorial

Stafi i angazhuar në proceset e transparencës ka nevojë për zhvillim të vazhdueshëm profesional jo vetëm në detyrat përkatëse, por edhe në aspektin e bashkëpunimit ndërsektorial. Trajnimet duhet të fokusohen në:

- teknikat e koordinimit dhe menaxhimit të rrjedhës së informacionit;
- përdorimin e platformave dhe sistemeve elektronike për publikim dhe raportim;
- etikën institucionale dhe aftësitë e komunikimit bashkëpunues.

2. Standardizimi i komunikimit ndërmjet sektorëve të brendshëm

Për të reduktuar fragmentimin dhe për të siguruar koherencë në procesin e transparencës, gjykatat duhet të aplikojnë protokolle të standardizuara të komunikimit ndërmjet strukturave funksionale përkatëse. Këto protokolle duhet të përfshijnë:

- njoftimin zyrtar për çdo material të destinuar për publikim, së bashku me afatet përkatëse;
- konfirmimin e publikimit dhe raportimin e çdo vështirësie teknike;
- verifikimin e përmbajtjes së materialeve për saktësi dhe përputhje me kuadrin ligjor;
- mbajtjen e evidencave periodike mbi publikimet dhe përditësimet.

3. Hartimi i manualeve të brendshme të procedurave

Çdo gjykatë duhet të hartojë manual të brendshëm për transparencën, i cili të përcaktojë qartë:

- procedurat e brendshme për publikimin e informacionit dhe për trajtimin e kërkesave për akses;
- formatet standarde të dokumenteve institucionale (njoftime, buletine, raporte informative);
- kalendarin e përditësimit të rubrikave të faqes zyrtare;
- mënyrën e koordinimit me institucionet qendrore dhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor.

4. Përfshirja e koordinimit në vlerësimin e performancës

Rekomandohet që procesi i vlerësimit vjetor të performancës së gjykatave të përfshijë indikatorë që matin cilësinë e koordinimit institucional. Këta indikatorë mund të lidhen me:

- ekzistencën dhe funksionimin e strukturave të dedikuara për transparencën;
- rregullsinë e mbledhjeve dhe bashkërendimin ndërsektorial;
- nivelin e përditësimit të faqes zyrtare;
- cilësinë dhe koherencën e komunikimit të brendshëm.

Këto elemente do të kontribuonin në forcimin e standardeve të transparencës dhe në nxitjen e një kulture të qëndrueshme bashkëpunimi institucional.

Përmbledhje: Koordinimi institucional dhe rolet administrative

1. Transparenca gjyqësore varet nga një koordinim efektiv ndërmjet strukturave të brendshme.
2. Mungesa e ndarjes së qartë të roleve krijon fragmentim dhe ul cilësinë e informacionit.
3. Komunikimi i pakoordinuar ndërmjet sektorëve cënon ritmin dhe koherencën e publikimeve.
4. Gjykatat nuk kanë manuale standarde që të udhëheqin procedurat e transparencës.
5. Angazhimi i kufizuar drejtues e dobëson prioritetin institucional të transparencës.
6. Nevojiten standarde, protokolle dhe trajnime për të krijuar një mekanizëm të unifikuar dhe funksional.

STANDARDIZIMI DHE CILËSIA E PUBLIKIMEVE

Standardizimi dhe cilësia e publikimeve

Përmbajtja dhe rëndësia

Transparenca gjyqësore nuk varet vetëm nga ekzistenca e dokumenteve publike, por edhe nga mënyra se si ato strukturohen, përditësohen dhe paraqiten në mënyrë të unifikuar dhe të kuptueshme.

Të dhënat e mbledhura nga instrumentet e vlerësimit tregojnë se mungesa e standardizimit në publikimet zyrtare përbën një nga problematikat më të qëndrueshme dhe më të dukshme në sistemin gjyqësor.

Ky fragmentim e vështirëson krahasimin ndërmjet gjykatave, matjen e progresit institucional dhe krijimin e një identiteti të unifikuar vizual dhe funksional të gjykatave si institucione publike.

1. Përmbajtje të pjesshme dhe jo gjithmonë të përditësuara

Një problematikë e përhapur lidhet me mungesën e përditësimit të rregullt të dokumenteve publike. Në shumë raste:

- programet e transparencës mbeten të pandryshuara për periudha të gjata;
- raportet vjetore të buxhetit, auditimit ose veprimtarisë mungojnë për vitin më të fundit;
- njoftimet për publikun publikohen pa datë ose ndalen në periudha të hershme të vitit.

Këto boshllëqe krijojnë perceptimin se faqet zyrtare nuk pasqyrojnë aktivitetin aktual të institucionit. Në disa raste, dokumentet e viteve të kaluara qëndrojnë ende si publikimi më i fundit, pavarësisht kalimit të afatit ligjor për përditësim. Mungesa e vazhdimësisë në publikim ndikon drejtpërdrejt në besueshmërinë e transparencës online dhe në aftësinë e publikut për të marrë informacion të saktë dhe të përditësuar.

2. Mospërputhje në formatet e publikimeve

Në disa raste, dokumentet janë të pajisura me elementet e nevojshme identifikuese (datë, version, autorësi), ndërsa në raste të tjera shfaqen si materiale të paidentifikuara, pa nënshkrim elektronik ose pa elemente që garantojnë autenticitetin.

Përdorimi i dokumenteve të skanuara si imazhe i bën ato të pakërkueshme (jo “searchable”) dhe të vështira për analizë, duke kufizuar aksesin e publikut dhe funksionalitetin e kërkimit të informacionit.

Në disa publikime vërehen edhe emërtime të ndryshme për të njëjtin lloj dokumenti, gjë që krijon paqartësi për përdoruesit dhe e vështirëson orientimin në faqen zyrtare.

Këto mospërputhje tregojnë mungesën e udhëzimeve kombëtare mbi standardet e formatit, titullimit dhe strukturës së dokumenteve për publikim publik.

Standardizimi dhe cilësia e publikimeve

3. Mungesë hierarkie dhe kategorizimi të qartë në rubrikat e faqeve

Në shumë raste, dokumentet e publikuara në faqet zyrtare nuk janë të kategorizuara sipas një strukture të qartë dhe të unifikuar. Materiale me natyra të ndryshme, akte ligjore, njoftime, vendime, raporte apo dokumente arkivore, shpesh paraqiten së bashku në të njëjtën rubrikë.

Kjo situatë lidhet me mungesën e një taksonomie të standardizuar për organizimin e informacionit, gjë që sjell:

- vështirësi për përdoruesit në identifikimin e dokumenteve të kërkuara;
- përsëritje të të njëjtit material në disa rubrika;
- humbje të funksionit sistematik të faqes si instrument transparence.

Mospasja e një strukture hierarkike të qartë ndikon negativisht në përdorueshmërinë, koherencën dhe qartësinë institucionale të faqes zyrtare.

4. Cilësi e pabarabartë në përmbajtjen e publikimeve

Cilësia e përmbajtjes së dokumenteve të publikuara ndryshon ndjeshëm ndërmjet gjykatave, duke reflektuar mungesën e standardeve të harmonizuara. Në disa raste, dokumentet janë të strukturuara në mënyrë profesionale, me hyrje shpjeguese dhe përmbledhje për publikun; në raste të tjera, ato paraqiten si materiale administrative pa kontekst apo shtjellim. Kjo dallueshmëri tregon mungesë të:

- mekanizmave të kontrollit të cilësisë para publikimit;
- përfshirjes së redaktimit institucional;
- udhëzimeve të qarta mbi standardin e tekstit dhe të dokumentimit publik.

Dokumente të rëndësishme, si rregulloret e brendshme apo aktet e etikës, ngarkohen herë pas here pa datë, pa version të identifikuar ose pa referenca të miratimit. Edhe pse teknike, këto elemente ndikojnë drejtpërdrejt në besueshmërinë dhe integritetin e informacionit të publikuar.

5. Mungesë kontrolli dhe auditimi të cilësisë së publikimeve

Aktualisht nuk ekziston një mekanizëm i strukturuar për kontrollin periodik të cilësisë dhe përditësimit të materialeve të publikuara online.

Në disa gjykata, verifikimi kryhet në mënyrë sporadike nga stafi teknik ose nga sektori i komunikimit, por pa një kalendar fiks, pa procedurë të standardizuar dhe pa raportim formal tek drejtuesit përgjegjës.

Në nivel qendror, mungon një sistem monitorimi ose njësi e dedikuar që të mbikëqyrë koherencën dhe standardet e publikimeve të gjykatave.

Për rrjedhojë, cilësia e transparencës online varet kryesisht nga burimet, praktikat e brendshme dhe kultura organizative e secilës gjykatë, duke krijuar hendek të dukshëm në konsistencë dhe performancë.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Hartimi i një modeli të unifikuar të publikimeve gjyqësore

Rekomandohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor të miratojë një model kombëtar për publikimet online të gjykatave, i cili të shërbejë si udhëzues standard për strukturën, përmbajtjen dhe cilësinë e informacionit të publikuar. Ky model duhet të përfshijë:

- listën minimale të dokumenteve që çdo gjykatë duhet të publikojë;
- formatin teknik të dokumenteve (p.sh. PDF/A, nënshkrim elektronik, emërtim standard, datë miratimi);
- strukturën e rubrikave dhe nënrubrikave;
- rregullat për renditjen, kategorizimin dhe arkivimin e përmbajtjes;
- kërkesat për përditësim periodik dhe kontroll cilësie.

Një model i tillë do të mundësojë koherencë në nivel kombëtar, krahasueshmëri ndërmjet gjykatave dhe lehtësim të procesit të monitorimit institucional nga KLGJ.

2. Vendosja e ciklit të detyrueshëm të përditësimit

Çdo gjykatë duhet të zbatojë një cikël të qartë përditësimi të faqes zyrtare, në përputhje me natyrën dhe afatet ligjore të informacionit. Ky cikël mund të përfshijë:

- dokumentet ligjore dhe rregulloret: përditësim çdo 12 muaj ose pas çdo ndryshimi ligjor;
- raportet financiare dhe buxhetore: publikim vjetor brenda tremujorit të parë;
- njoftimet për prokurime dhe pozicione vakante: publikim menjëherë pas shpalljes në portalet përkatëse;
- raportet e auditimit dhe analizat vjetore: publikim menjëherë pas miratimit.

Ky cikël duhet të formalizohet në një kalendar pune të miratuar nga drejtuesi i gjykatës dhe të monitorohet nga struktura përgjegjëse administrative, për të siguruar rregullsi dhe përputhje me standardet e transparencës.

3. Përdorimi i formatit të unifikuar për dokumentet

Rekomandohet që të gjitha dokumentet e destinuara për publikim të ndjekin standarde të unifikuara teknike, me qëllim sigurimin e koherencës, integritetit dhe aksesueshmërisë së informacionit. Këto standarde duhet të përfshijnë:

- përdorimin e formatit PDF/A për ruajtje afatgjatë dhe stabilitet teknik;
- emërtim të standardizuar sipas formulës: Emërtimi i dokumentit_viti_data;
- përfshirjen e metadatave institucionale (data, versioni, burimi, struktura përgjegjëse);
- nënshkrim digjital, kur është e aplikueshme;
- vendosjen e elementeve vizuale standardë, si logoja institucionale dhe adresa zyrtare.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Struktura standarde për kategorizimin e përmbajtjes

Rekomandohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor të përcaktojë një strukturë të unifikuar për ndarjen e rubrikave të transparencës online, me qëllim krijimin e një organizimi të qartë dhe të krahasueshëm ndërmjet të gjitha gjykatave. Një ndarje e rekomanduar mund të përfshijë:

- Programin e Transparencës
- Aktet ligjore dhe rregulloret
- Buxhetin dhe raportet financiare
- Prokurimet publike
- Raportet e auditimit dhe vlerësimit
- Njoftimet institucionale
- Vendet vakante dhe shërbimin civil gjyqësor
- Publikimet dhe buletinet informuese

Çdo nënrubrikë duhet të shoqërohet me një përshkrim të shkurtër shpjegues dhe me datë të qartë përditësimi. Zbatimi i një strukture të standardizuar rrit qartësinë, lehtëson orientimin e publikut dhe përmirëson monitorimin krahasues në nivel kombëtar.

5. Vendosja e mekanizmit të brendshëm të kontrollit cilësor

Për të siguruar saktësinë dhe koherencën e publikimeve, çdo gjykatë duhet të vendosë një proces formal verifikimi përpara publikimit. Ky proces mund të përfshijë:

- kontrollin e përmbajtjes nga struktura përgjegjëse për transparencën;
- verifikimin teknik nga njësia IT;
- miratimin përfundimtar nga drejtuesi ose nga kancelaria.

Rekomandohet përdorimi i një formulari standard të brendshëm për publikim, ku të regjistrohen data, përgjegjësi dhe konfirmimi i miratimit. Arkivimi i këtij formulari siguron gjurmueshmëri institucionale dhe rrit përgjegjshmërinë e procesit.

6. Auditimi periodik i transparencës online

Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të krijojë një mekanizëm të rregullt, mundësisht vjetor, për auditimin e transparencës online të gjykatave, bazuar në indikatorë të qartë dhe të matshëm. Auditimi mund të vlerësojë:

- përditësimin e dokumenteve;
- përputhjen me strukturën standarde të publikuar;
- cilësinë dhe qartësinë e përmbajtjes;
- aksesueshmërinë teknike të materialeve.

Rezultatet e auditimit duhet të përfshihen në një raport vjetor të transparencës gjyqësore, duke paraqitur nivelin e përmbushjes për secilën gjykatë dhe duke nxjerrë në pah praktikat më të mira që mund të shërbejnë si model kombëtar.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

7. Përfshirja e cilësisë së publikimeve në vlerësimin e performancës

Rekomandohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor të integrojë indikatorë mbi cilësinë dhe standardizimin e publikimeve në sistemin e vlerësimit të performancës administrative të gjykatave. Këta indikatorë mund të matin:

- rregullsinë e përditësimeve;
- përputhjen me formatet dhe standardet e përcaktuara;
- qartësinë dhe strukturimin e dokumenteve;
- raportimin periodik mbi publikimet dhe përmbajtjet online.

Integrimi i këtyre elementeve e shndërron transparencën nga një proces formal në një kriter të matshëm vlerësimi institucional, duke theksuar rëndësinë e saj në funksionimin e përditshëm të gjykatave.

8. Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhimin e publikimeve

Rekomandohet zhvillimi i programeve të trajnimit për personelin që merret me publikimet, komunikimin dhe administrimin e transparencës online. Trajnimet duhet të përfshijnë:

- standardet teknike dhe përdorimin e metadatave;
- përgatitjen profesionale të materialeve për publikim;
- përdorimin e gjuhës së qartë dhe komunikimin e orientuar drejt publikut;
- etikën institucionale dhe administrimin e informacionit publik.
-

Zhvillimi i këtyre kapaciteteve siguron që stafi të zotërojë aftësitë e nevojshme për përgatitjen e përmbajtjeve të sakta, të qarta dhe të aksesueshme, duke rritur cilësinë e përgjithshme të transparencës online në nivel institucional.

Përmbledhje: Standardizimi dhe cilësia e publikimeve

1. Mungesa e standardizimit pengon krahasueshmërinë dhe qartësinë e publikimeve gjyqësore.
2. Dokumentet shpesh janë të papërditësuara dhe të pauniformuara në format dhe strukturë.
3. Kategorizimi jo sistematik i rubrikave vështirëson orientimin e publikut.
4. Cilësia e pabarabartë e përmbajtjes reflekton mungesë kontrolli dhe udhëzimesh të qarta.
5. Nevojitet mekanizëm i rregullt verifikimi dhe auditimi nga gjykatat dhe KLGJ.
6. Standardet kombëtare dhe ndërtimi i kapaciteteve do të rrisin koherencën dhe besueshmërinë e transparencës.

TRANSPARENCA AKTIVE PËRKUNDREJT TRANSPARENCËS PASIVE

Transparenca aktive përkundrejt transparencës pasive

Përmbajtja dhe rëndësia

Transparenca gjyqësore përfshin dy dimensione thelbësore: Transparencën aktive, që nënkupton publikimin proaktiv të informacionit nga vetë institucionet; dhe Transparencën pasive, që lidhet me ofrimin e informacionit në përgjigje të kërkesave nga publiku. Të dhënat e mbledhura tregojnë se balanca ndërmjet këtyre dy dimensioneve anon dukshëm drejt transparencës pasive. Përveç publikimeve të detyruara, një pjesë e konsiderueshme e gjykatave funksionojnë kryesisht në mënyrë reaguese, duke publikuar informacion vetëm kur kërkohet dhe jo në mënyrë sistematike. Kjo e kufizon rolin e transparencës si instrument i llogaridhënies dhe i komunikimit të hapur me publikun.

1. Dominimi i transparencës pasive (reaguese)

Nga analizat e kryera rezulton se transparenca aktive mbetet e kufizuar në shumicën e gjykatave. Publikimet kryesore synojnë përmbushjen e kërkesave minimale ligjore, pa një qasje të strukturuar komunikimi me publikun. Në praktikë:

- publikohen dokumentet e detyrueshme, shpesh pa përditësim ose pa shpjegim orientues;
- shumë rubrika ekzistojnë formalisht, por me përmbajtje statike dhe pa informacion të ri;
- transparenca realizohet kryesisht përmes përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion dhe jo përmes nismave vetë-publikuese.

Kjo dinamikë tregon se transparenca shihet ende si detyrim administrativ, jo si mjet i rëndësishëm për ndërtimin e besimit publik dhe forcimin e llogaridhënies.

2. Mungesë e qasjes proaktive në publikimin e informacionit

Të dhënat nga instrumentet e vlerësimit tregojnë se vetëm një numër i kufizuar gjykatash ndërmarrin nisma të zgjeruara të transparencës aktive. Në pjesën më të madhe të institucioneve mungojnë:

- publikime të përmbledhjeve vjetore për publikun në format të thjeshtëzuar;
- komunikata sqaruese mbi funksionet, rezultatet, ose zhvillimet institucionale;
- buletine ose materiale periodike informuese.

Edhe aty ku ka përpjekje për komunikim proaktiv, ato mbeten sporadike dhe pa një strategji të përbashkët. Kjo tregon se kultura institucionale e komunikimit me publikun është ende në fazë zhvillimi dhe nuk është e standardizuar në nivel kombëtar.

3. Mungesë koordinimi ndërmjet transparencës aktive dhe pasive

Transparenca aktive dhe ajo pasive nuk janë të integruara në një qasje të unifikuar. Në shumicën e rasteve, kërkesat për informacion nuk analizohen për të identifikuar boshllëqet e publikimeve ekzistuese dhe as për të përmirësuar programin e transparencës. Koordinatorët raportojnë se trajtimi i kërkesave për informacion mbetet një proces i izoluar, pa mekanizma analitikë që të lidhin përmbajtjen e kërkesave me nevojat e publikut dhe me politikat e komunikimit të gjykatës. Mungesa e këtij cikli reflektimi dhe integrimi bën që institucionet të mos përfitojnë nga reagimi i publikut dhe të mos e shndërrojnë transparencën pasive në motor për përmirësimin e transparencës aktive.

Transparenca aktive përkundrejt transparencës pasive

4. Proces i pjesshëm dhe jo sistematik i trajtimit të kërkesave për informacion

Edhe pse kërkesat për informacion trajtohen në përputhje me ligjin nr. 119/2014, mënyra e administrimit të tyre ndryshon ndjeshëm ndërmjet gjykatave. Të dhënat e mbledhura tregojnë se:

- disa gjykata mbajnë regjistra të plotë, fizikë ose elektronikë, për kërkesat dhe përgjigjet;
- disa të tjera përdorin metoda manuale ose trajtim vetëm përmes emailit;
- nuk ekziston një sistem i standardizuar raportimi vjetor mbi numrin, tipologjinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit të kërkesave.

Këto diferenca tregojnë se menaxhimi i transparencës pasive nuk është i unifikuar dhe shpesh varet nga praktikat e brendshme të çdo institucioni. Në disa raste, kërkesat trajtohen nga koordinatori pa bashkërendim me sektorët përkatës, çka mund të sjellë vonesa, përgjigje të pjesshme ose mungesë dokumentimi. Mungesa e statistikave periodike e kufizon aftësinë e KLGJ-së për të monitoruar zbatimin e të drejtës për informacion në nivel sistemi.

5. Qasje formale ndaj detyrimeve ligjore

Në shumë gjykata, transparenca aktive interpretohet kryesisht si përmbushje e listës ligjore të dokumenteve që duhet të publikohen, dhe më pak si proces komunikimi me publikun. Kjo reflektohet në:

- programe transparence të hartuara sipas modeleve standarde, pa përshtatje ndaj karakteristikave të gjykatës;
- mungesën e materialeve shpjeguese për funksionet, procedurat dhe rezultatet institucionale;
- publikime që rrallë shoqërohen me gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

Kjo qasje formale e shkëput transparencën nga qeverisja institucionale, duke e reduktuar në një detyrim procedural dhe jo në mekanizëm për rritjen e besimit dhe llogaridhënies publike.

6. Varësi nga individë, jo nga sisteme

Në një pjesë të gjykatave, funksionimi i transparencës, si aktive, ashtu edhe pasive, varet kryesisht nga angazhimi individual i personelit përgjegjës dhe jo nga procedura të mirëpërcaktuara. Ndryshimet në përbërjen e stafit shpesh sjellin ndërprerje ose rënie të cilësisë së publikimeve, për shkak të mungesës së:

- standardeve institucionale të publikimit;
- dokumentacionit të brendshëm si manuale, procedura dhe kalendarë pune;
- mekanizmave të qartë mbikëqyrës nga drejtuesit.

Kjo tregon se transparenca ende nuk është tërësisht e institucionalizuar dhe mbetet në masë të madhe e lidhur me praktika individuale, jo me sisteme të qëndrueshme administrative.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Forcimi i transparencës aktive përmes publikimeve proaktive

Për të kaluar nga transparenca formale në një transparencë funksionale dhe me ndikim real, gjykatat duhet të publikojnë informacion përtej detyrimeve ligjore. Kjo mund të përfshijë:

- përmbledhje vjetore për publikun, të përgatitura me gjuhë të qartë dhe elementë vizualë (grafikë, infografikë);
- njoftime mbi zhvillimet organizative, përmirësime teknologjike, ndryshime orari apo bashkëpunime institucionale;
- statistika vjetore të performancës, të paraqitura në format të kuptueshëm dhe të aksesueshëm;
- praktika të mira ose shembuj pozitivë që kontribuojnë në rritjen e besimit publik.

Kjo formë transparence aktive shndërron informacionin e publikuar nga detyrim formal në komunikim institucional, duke rritur hapjen dhe qartësinë për qytetarët.

2. Përdorimi i statistikave për përmirësim të transparencës

Gjykatat duhet të administrojnë statistika mujore dhe vjetore që lidhen me zbatimin e të drejtës për informim, duke përfshirë:

- numrin e kërkesave për informacion;
- kategoritë më të kërkuara të të dhënave;
- afatet mesatare të dhënies së përgjigjeve;
- rastet e refuzimeve dhe arsyet përkatëse.

Këto të dhëna duhet të jenë pjesë e raportit vjetor të gjykatës dhe të përdoren për të orientuar publikimet proaktive, për shembull, nëse një informacion kërkohet shpesh, ai duhet të publikohet automatikisht në faqen zyrtare. Ky mekanizëm shndërron kërkesat e publikut në instrument politikëbërës dhe e bën transparencën të vetëshpjegueshme dhe të qëndrueshme.

3. Përfshirja e komenteve të publikut në përmirësimin e transparencës

Gjykatat duhet të krijojnë mekanizma të thjeshtë për mbledhjen dhe analizimin e reagimeve të publikut, si:

- formularë "Sugjerime dhe vërejtje" të integruar në faqen zyrtare;
- rubrika "Pyetje të shpeshta (FAQ)" që përditësohet rregullisht në bazë të kërkesave më të zakonshme;
- sondazhe periodike për vlerësimin e kënaqësisë së publikut me faqen e internetit dhe me informacionin e ofruar.

Këto instrumente forcojnë ndërveprimin ndërmjet gjykatës dhe qytetarëve, duke e kthyer transparencën në proces komunikimi dypalësh, jo thjesht në publikim dokumentesh.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Integrimi i transparencës aktive dhe pasive në vlerësimin institucional

Rekomandohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor të përfshijë indikatorë të dedikuar për transparencën aktive dhe pasive në sistemin e monitorimit të performancës së gjykatave. Këta indikatorë mund të matin:

- përqindjen e dokumenteve të përditësuara brenda afateve ligjore;
- numrin mesatar të kërkesave për informacion të trajtuara brenda afateve;
- numrin e publikimeve proaktive të realizuara gjatë vitit;
- përdorimin e statistikave për përmirësimin e përmbajtjes së publikimeve.

Përfshirja e këtyre treguesve e shndërron transparencën në element vlerësimi objektiv dhe të matshëm, të lidhur drejtpërdrejt me menaxhimin institucional dhe perceptimin e publikut.

5. Ngritja e kapaciteteve të stafit për transparencë proaktive

Rekomandohet zhvillimi i programeve të përbashkëta trajnimi për koordinatorët e informacionit, stafin e komunikimit dhe njësitë teknike, me qëllim rritjen e kompetencave në fushën e transparencës. Temat mund të përfshijnë:

- balancimin midis transparencës dhe konfidencialitetit institucional;
- hartimin e përmbajtjeve të qarta dhe profesionale për publikun;
- administrimin efikas të kërkesave për informacion;
- analizimin dhe integrimin e komenteve të publikut në përmirësimin e publikimeve.

Zhvillimi i këtyre kapaciteteve ndihmon në krijimin e një kulture institucionale që e trajton transparencën si pjesë të pandashme të performancës, integritetit dhe llogaridhënies publike.

Përmbledhje: Transparenca aktive përkundrejt transparencës pasive

1. Transparenca gjyqësore mbetet kryesisht reaguese dhe jo proaktive.
2. Publikimet shpesh kufizohen në detyrimet ligjore, pa qasje komunikimi me publikun.
3. Mungon integrimi ndërmjet transparencës aktive dhe asaj pasive.
4. Trajtimi i kërkesave për informacion nuk është i standardizuar dhe ndryshon mes gjykatave.
5. Transparenca varet ende nga individë, jo nga sisteme dhe procedura të qëndrueshme.
6. Nevojiten standarde, statistika dhe trajnime për të ndërtuar një transparencë funksionale dhe institucionale.

TEKNOLOGJIA DHE AUTOMATIZIMI I PROCESEVE

Teknologjia dhe automatizimi i proceseve

Përmbajtja dhe rëndësia

Teknologjia përbën një shtyllë thelbësore të transparencës moderne gjyqësore, pasi mundëson qasje të shpejtë në informacion, publikime të sinkronizuara, menaxhim elektronik të dokumenteve dhe komunikim të strukturuar me publikun. Megjithatë, të dhënat e mbledhura tregojnë se automatizimi i proceseve të transparencës në gjykatat shqiptare mbetet i pjesshëm dhe i paintegruar. Në mungesë të sistemeve digjitale të koordinuara, funksionimi i transparencës varet nga ndërhyrja manuale e stafit administrativ, duke ulur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë institucionale.

1. Mungesë e përdorimit të plotë të sistemeve elektronike ekzistuese

Sistemet elektronike të menaxhimit gjyqësor (ICMIS) përdoren në disa procese procedurale, por nuk janë të lidhura me transparencën publike. Aktualisht, publikimet në faqet zyrtare nuk gjenerohen automatikisht nga sistemi elektronik. Në vend të kësaj:

- dokumentet përgatiten, nënshkruhen dhe ngarkohen manualisht;
- verifikimet teknike kryhen manualisht nga stafi IT;
- afatet e publikimit varen nga kapacitetet njerëzore dhe jo nga automatizimi.

Kjo situatë kufizon efikasitetin operacional dhe rrit mundësinë për vonesa, gabime dhe boshllëqe në publikime.

2. Varësi nga publikimet manuale dhe ndërhyrja njerëzore

Sipas të dhënave të pyetësorit, të gjitha gjykatat raportojnë se publikimet kryhen manualisht, kryesisht nga njësitë IT ose nga koordinatorët e transparencës. Mungesa e automatizimit ndikon në:

- uljen e frekuencës së publikimeve;
- rritjen e gabimeve teknike dhe të versionimit;
- varësinë nga disponueshmëria dhe kapacitetet individuale të stafit.

Në disa raste, dokumentet ngarkohen në formate të papërshtatshme ose me versione të paaktualizuara, pikërisht për shkak të mungesës së mekanizmave automatikë të kontrollit dhe sinkronizimit.

3. Pamundësia për të gjeneruar raporte automatike dhe statistika

Asnjë nga faqet aktuale të gjykatave nuk ka kapacitet të gjenerojë automatikisht raporte statistikore mbi vizitat, shkarkimet apo ndërveprimet e publikut. Kryesisht mungojnë:

- mekanizma të integruar për analizimin e trafikut dhe identifikimin e kërkesave më të shpeshta;
- sisteme për ndjekjen e afateve të publikimit dhe përditësimeve;

Kjo e bën të pamundur monitorimin dinamik të transparencës online dhe vlerësimin e ndikimit real të saj, duke kufizuar aftësinë e gjykatave për të përmirësuar qasjen dhe përmbajtjen në bazë të të dhënave.

Teknologjia dhe automatizimi i proceseve

4. Mungesë sistemi për ruajtjen digjitale të historikut të publikimeve

Në shumicën e gjykatave mungon një arkiv digjital i strukturuar për publikimet e viteve të mëparshme. Si pasojë:

- materialet e vjetra mund të fshihen ose të humbasin;
- nuk është e mundur të ndiqet evolucioni i transparencës në kohë;
- dokumentet aktuale shpesh zëvendësojnë versionet e mëparshme, pa ruajtur historikun.

Mungesa e kësaj memorie institucionale digjitale e bën të vështirë auditimin retrospektiv të transparencës dhe ul nivelin e përgjegjshmërisë, pasi nuk ekziston një gjurmë e plotë e publikimeve të kryera ndër vite.

5. Kapacitete të kufizuara teknike dhe mungesë personeli të specializuar

Një gjetje e përsëritur është mungesa e burimeve të dedikuara teknike dhe e stafit të specializuar për transparencë digjitale. Në shumë gjykata, të njëjtat role administrojnë një gamë të gjerë detyrash, nga mirëmbajtja e sistemeve të brendshme deri te përditësimi i faqes zyrtare. Kjo shpie në:

- vonesa në publikime dhe përditësime;
- rritje të gabimeve teknike;
- vështirësi në menaxhimin e platformave të shumta paralelisht.

Asnjë gjykatë nuk raporton të ketë personel të dedikuar ekskluzivisht për transparencën digjitale, çka kufizon zhvillimin afatgjatë të standardeve moderne të publikimit dhe mirëmbajtjes së informacionit online.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Integrimi i transparencës me sistemet ekzistuese gjyqësore

Rekomandohet që transparenca të integrohet me sistemet elektronike ekzistuese të administrimit gjyqësor (ICMIS, sistemet e njoftimeve, regjistrat procedurale dhe sistemet buxhetore). Kjo do të mundësonte:

- publikimin automatik të të dhënave që nuk cënojnë konfidencialitetin (si statistikat vjetore, raportet e zbatimit të buxhetit, njoftimet për seanca publike);
- sinkronizimin e menjëhershëm të informacionit të miratuar në portalin qendror;
- ruajtjen e njëtrajtësisë ndërmjet informacionit administrativ të brendshëm dhe atij publik.

Në këtë mënyrë, transparenca shndërrohet në pjesë integrale të zinxhirit të informacionit gjyqësor dhe jo në një proces paralel që kërkon ndërhyrje të veçanta administrative.

2. Automatizimi i përditësimeve rutinë

Për publikimet periodike, të cilat përsëriten çdo vit (p.sh. programet e transparencës, raportet vjetore, dokumentet buxhetore), rekomandohet zhvillimi i një mekanizmi automatik njoftimi për afatet e publikimit. Shembuj funksionesh të mundshme:

- sistemi gjeneron sinjal automatik kur afati ligjor për publikim po afron;
- koordinatorët marrin njoftim përmes ndërfaqes së unifikuar dhe ngarkojnë dokumentin përkatës;
- pas publikimit, dokumenti pajiset automatikisht me metadata të tilla si “Publikuar më ___”.

Kjo qasje siguron ritëm të qëndrueshëm përditësimesh, redukton vonesat dhe ndihmon në ruajtjen e kujtesës institucionale.

3. Vendosja e funksionit “auto-archive” për ruajtjen historike

Rekomandohet që faqet zyrtare të gjykatave të përfshijnë një funksionalitet arkivimi automatik, i cili të mundësojë:

- ruajtjen e versioneve të mëparshme të dokumenteve në një nënrubrikë të dedikuar (“Arkiva e publikimeve”);
- regjistrimin automatik të datës së publikimit dhe versionimit;
- kërkimin sipas vitit, kategorisë ose llojit të dokumentit.

Ky mekanizëm rrit gjurmueshmërinë institucionale, mundëson auditim retrospektiv dhe i jep procesit të transparencës memorien digjitale që aktualisht mungon.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Krijimi i një sistemi të raportimit analitik për transparencën online

Rekomandohet që faqet zyrtare të gjykatave të lidhen me një modul të integruar raportimi statistik, i cili të gjenerojë automatikisht të dhëna mbi:

- numrin e vizitave në faqe;
- dokumentet më të shkarkuara;
- kategoritë më të kërkuara nga publiku;
- afatet mesatare të përditësimit të përmbajtjes.

Këto tregues duhet të transmetohen tek KLGJ në periudha të rregullta kohore, duke mundësuar krijimin e një panorame operacionale të transparencës gjyqësore në nivel kombëtar. Përmes këtij sistemi, KLGJ mund të hartojë raporte krahasuese dhe të nxisë përmirësim të vazhdueshëm përmes konkurrencës pozitive ndërmjet gjykatave.

5. Përdorimi i modeleve "dashboard" për menaxhimin e transparencës

Rekomandohet që çdo gjykatë të ketë akses në një panel digjital ("dashboard") të brendshëm, që i mundëson drejtuesve, koordinatorëve dhe njësive teknike të monitorojnë në kohë reale:

- dokumentet që mungojnë ose që janë jashtë afatit të publikimit;
- përqindjen e përditësimit për secilën rubrikë;
- afatet e ardhshme të detyrimeve të publikimit;
- statistikat e ndërveprimit të publikut me faqen.

Një panel i tillë e shndërron transparencën nga një proces kryesisht reaktiv në një mekanizëm aktiv menaxhimi dhe monitorimi të përditshëm.

6. Rritja e kapaciteteve digjitale dhe teknike në gjykata

Rekomandohet që çdo gjykatë të ketë stafin e plotë përgjegjës të trajnuar posaçërisht për transparencën elektronike, i cili të zotërojë aftësi në:

- administrimin e faqeve të internetit;
- menaxhimin e sistemeve të publikimit elektronik;
- arkivimin digjital dhe sigurinë e të dhënave.

KLGJ mund të krijojë një program modular trajnimi, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, i fokusuar në:

- teknologjitë e menaxhimit të dokumenteve;
- standardet e metadata-s;
- sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit institucional.

Ky investim krijon një bazë kombëtare kompetencash teknologjike, duke siguruar që transparenca digjitale të mbështetet në kapacitete të qëndrueshme dhe profesionale.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

7. Zbatimi i standardeve të sigurisë dhe backup-it digjital

Automatizimi i proceseve duhet të shoqërohet me protokolle të qëndrueshme sigurie për të garantuar integritetin dhe vazhdimësinë e të dhënave. Rekomandohet:

- përdorimi i certifikatave SSL dhe realizimi i kopjeve rezervë javor për të gjitha faqet zyrtare të gjykatave;
- ruajtja e rezervimeve në serverë të ndarë fizikisht nga sistemi kryesor;
- regjistrim automatik i çdo modifikimi apo fshirjeje (audit trail).

Këto masa rrisin besueshmërinë institucionale dhe sigurinë digjitale, duke mbrojtur integritetin e informacionit të publikuar dhe duke siguruar transparencë të pandërprerë.

8. Roli i KLGJ si garant i unifikimit digjital

Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të ushtrojë një rol koordinues në drejtim të standardizimit dhe zhvillimit teknologjik të transparencës gjyqësore, përmes:

- miratimit të një Udhëzimi për Standardet Teknike të Faqeve Gjyqësore;
- krijimit të një njësie të specializuar për monitorimin digjital brenda administratës së tij;
- hartimit të raporteve vjetore për performancën teknologjike të gjykatave;
- mbështetjes financiare dhe teknike për gjykatat që kërkojnë modernizimin e infrastrukturës.

Ky rol i konsoliduar garanton qasje të barabartë në standarde, uniformitet të praktikave dhe bashkëpunim ndërinstitucional në procesin e digjitalizimit të transparencës.

Përmbledhje: Teknologjia dhe automatizimi i proceseve

1. Transparenca digjitale mbetet e fragmentuar dhe jo e integruar me sistemet ekzistuese gjyqësore.
2. Publikimet kryhen kryesisht manualisht, duke krijuar vonesa dhe paqëndrueshmëri.
3. Mungojnë statistikat automatike dhe raportimi analitik për ndërveprimin publik.
4. Sistemet aktuale nuk ofrojnë arkivim digjital dhe ruajtje historike të dokumenteve.
5. Kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore janë të kufizuara dhe jo të specializuara.
6. Nevojiten standarde të unifikuara, automatizim, siguri digjitale dhe rol koordinues i KLGJ-së.

KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

Komunikimi me publikun dhe median

Përmbajtja dhe rëndësia

Komunikimi me publikun dhe median është një komponent thelbësor i transparencës gjyqësore, pasi ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si perceptohet drejtësia dhe sa besim ngjall institucioni tek qytetarët. Përmes komunikimit të qartë, të verifikuar dhe të rregullt, gjykatat jo vetëm informojnë, por edhe shpjegojnë rolin, kufijtë dhe parimet që udhëheqin veprimtarinë e tyre. Gjetjet e analizës tregojnë se komunikimi publik në gjykatat shqiptare mbetet i fragmentuar, pavarësisht ekzistencës së strategjive dhe udhëzimeve të përgjithshme në nivel qendror.

1. Mungesë strategjie të unifikuar komunikimi

Asnjë nga gjykatat nuk ka të miratuar një strategji ose plan të integruar komunikimi me publikun dhe median në nivel institucional. Komunikimi kryhet kryesisht në formë njoftimesh operative (si publikimi i shortit, orarit të seancave apo informacioneve procedurale), duke munguar një qasje e planifikuar që synon edukim publik, ndërgjegjësim dhe shpjegime të natyrës institucionale. Si pasojë, komunikimi shpesh varet nga praktikat e krijuara nga stafi ose drejtuesit, dhe jo nga një politikë e konsoliduar e institucionit.

2. Rol jo aktiv i gjyqtarit për median dhe i zyrtarit të komunikimit

Megjithëse të gjitha gjykatat kanë të emëruar një Gjyqtar për Median dhe një Zyrtar për Marrëdhëniet me Publikun, roli i tyre në praktikë mbetet shpesh pasiv dhe i paoperacionalizuar plotësisht. Në shumë raste:

- komunikimi nuk realizohet në mënyrë të rregullt ose të planifikuar;
- ndërveprimi me median kufizohet në përgjigje sporadike ose në raste të veçanta;
- mungon përfshirja e tyre në hartimin e mesazheve, verifikimin e informacionit ose planifikimin e komunikimit publik;
- detyrat e tyre ndërthuren me role të tjera administrative, duke kufizuar kohën dhe fokusin profesional.

Kjo situatë ndikon në koherencën e komunikimit publik dhe e bën të vështirë krijimin e një pranie institucionale të qartë, të qëndrueshme dhe profesionale në media.

3. Mungesë rregulloresh dhe udhëzuesish për komunikimin institucional

Vetëm një numër i kufizuar gjykatash kanë rregullore apo udhëzues për komunikimin me median, dhe ato shpesh nuk janë të përshtatura sipas kontekstit lokal. Në praktikë mungon:

- përcaktimi i informacionit që mund të publikohet;
- procedura e verifikimit të të dhënave përpara publikimit;
- standardet e gjuhës dhe formatit të komunikimit publik;
- qasja e strukturuar për trajtimin e çështjeve të ndjeshme ose të mediatizuara.

Këto boshllëqe shkaktojnë pasiguri institucionale dhe, në disa raste, heshtje për çështje ku kërkohet qartësi publike.

Komunikimi me publikun dhe median

4. Qasje reaktive, jo proaktive ndaj mediave

Komunikimi gjyqësor mbetet kryesisht reaktiv, ku përgjigjet jepen vetëm në rast kërkesash nga media ose situatash emergjente, në vend të një komunikimi proaktiv, informues dhe të planifikuar. Shumica e publikimeve kufizohen në dokumente të detyrueshme (shortet, oraret e seancave, vendimet), ndërsa mungojnë:

- publikime periodike shpjeguese për publikun;
- përmbajtje edukative mbi funksionimin e gjykatës;
- komunikata të rregullta mbi statistika apo zhvillime institucionale;
- prezantimi i praktikave pozitive apo risive administrative.

Si rezultat, prezenca mediatike e gjykatave ndodh kryesisht në situata të ndjeshme, duke krijuar pamje të pjesshme për publikun.

5. Mungesë trajnimi dhe kapacitetesh profesionale

Komunikimi institucional kërkon aftësi të specializuara në komunikim publik, marrëdhënie me median dhe menaxhim të situatave të ndjeshme, por shumica e zyrtarëve të ngarkuar me këtë funksion nuk kanë marrë trajnim të posaçëm në këto fusha. Në disa gjykata mungon edhe infrastruktura bazë mbështetëse, si pajisje audio-vizuale, mjete grafike ose platforma digjitale të dedikuara. Si rezultat, mesazhet publike shpesh janë të kufizuara në përmbajtje, të paformatuara në mënyrë vizualisht tërheqëse dhe me impakt të kufizuar tek publiku i gjerë.

6. Mungesë koordinimi me KLGJ dhe komunikim të centralizuar

Ndërveprimi ndërmjet nivelit qendror dhe gjykatave në fushën e komunikimit publik mbetet i fragmentuar dhe pa mekanizma të qartë bashkërendimi. Edhe pse ekzistojnë komunikime qendrore dhe udhëzime të përgjithshme, mungon një strukturë e centralizuar që të harmonizojë mesazhet, afatet dhe qasjen komunikative në nivel sistemi. Gjykatat veprojnë kryesisht në mënyrë të pavarur, pa shkëmbim të rregullt të materialeve informuese, kalendarëve mediatikë apo praktikave të përbashkëta. Kjo situatë kufizon krijimin e një identiteti të unifikuar komunikues dhe zvogëlon koherencën institucionale në raport me publikun.

7. Përdorim minimal i kanaleve moderne të komunikimit

Përdorimi i kanaleve moderne të komunikimit, si rrjetet sociale (Facebook, Instagram, YouTube), mbetet minimal dhe jo gjithmonë i strukturuar. Në gjykatat që i përdorin, komunikimi kufizohet kryesisht në shpërndarje njoftimesh formale, pa strategji digjitale që të kombinojë informimin me edukimin publik dhe ndërtimin e besimit. Në disa raste, faqet ekzistojnë, por administrohen në mënyrë joaktive, duke krijuar përshtypjen e mungesës së angazhimit të vazhdueshëm institucional në komunikim publik.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Hartimi i strategjisë së përbashkët të komunikimit gjyqësor

Rekomandohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me gjykatat, të hartojë dhe miratojë një Strategji Kombëtare të Komunikimit Gjyqësor, e cila përcakton objektivat, audiencat kryesore, mesazhet institucionale dhe mjetet e komunikimit. Strategjia duhet të mbështetet mbi tre shtylla themelore:

- Informimin publik lidhur me vendimmarrjen, proceset dhe transparencën;
- Edukimin qytetar mbi të drejtat, procedurat dhe funksionimin e gjykatave;
- Ndërtimin e besimit publik përmes qartësisë, koherencës dhe përgjegjshmërisë.

Gjithashtu, çdo gjykatë duhet të hartojë plane vjetore komunikimi, të cilat përfshijnë kalendar aktivitetesh, mesazhe prioritare dhe përcaktim të përgjegjësive.

2. Forcimi i rolit të gjyqtarit për median dhe zyrtarit të komunikimit

Megjithëse të gjitha gjykatat kanë të caktuar një Gjyqtar për Median dhe një Zyrtar për Marrëdhëniet me Publikun, funksionimi i këtyre roleve mbetet kryesisht pasiv dhe i kufizuar në detyra formale. Për rritjen e efektivitetit, nevojitet një profil më i qartë pune që të specifikojë qartë pritshmëritë institucionale, rolin në menaxhimin e informacionit publik, mënyrën e ndërveprimit me median, procedurat për trajtimin e kërkesave dhe përgjegjësitë gjatë situatave të komunikimit krizë.

Për të rritur kapacitetet, rekomandohet zhvillimi periodik i trajnimeve në komunikim publik, etikë profesionale dhe menaxhim informacioni, si dhe krijimi i një mekanizmi bashkërendimi ndërmjet zyrtarëve të komunikimit të gjykatave, që të mundësojë shkëmbim praktikash, harmonizim të njoftimeve dhe koordinim të qasjes mediatike në nivel sistemi.

3. Miratimi i udhëzuesit për komunikimin me median

Rekomandohet që KLGJ të miratojë një Udhëzues Kombëtar për Komunikimin me Median, i detyrueshëm për të gjitha gjykatat, i cili të përfshijë:

- rregullat për publikimin e informacionit gjyqësor;
- kufijtë e transparencës gjatë shqyrtimit të çështjeve;
- procedurat për trajtimin e kërkesave të mediave;
- udhëzime për menaxhimin e rasteve të ndjeshme ose të mediatizuara;
- standardet për njoftimet për shtyp dhe komunikatat institucionale.

Udhëzuesi duhet të mbështetet në parimin e balancës ndërmjet të drejtës për informim dhe ruajtjes së sekretit gjyqësor, duke siguruar komunikim të përgjegjshëm, të njëtrajtshëm dhe profesional në të gjithë sistemin gjyqësor.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Kalimi nga komunikimi reaktiv në komunikim proaktiv

Rekomandohet që gjykatat të kalojnë gradualisht nga komunikimi kryesisht reaktiv në një model proaktiv dhe të strukturuar të informimit publik. Kjo përfshin:

- publikimin periodik të njoftimeve mbi ecurinë e punës dhe zhvillimet institucionale;
- përgatitjen e kronikave informuese, buletineve mujore ose videove të shkurtra shpjeguese mbi funksionet, shërbimet dhe praktikat e mira;
- hartimin e një kalendari vjetor komunikimi, që përfshin "Ditët e Hapura", prezantimet e raporteve vjetore, nisma të edukimit ligjor dhe javët e transparencës.

Kjo qasje proaktive kontribuon në rritjen e besimit publik dhe e pozicionon gjykatën si institucion të hapur dhe të përgjegjshëm ndaj qytetarëve.

5. Përdorimi i kanaleve moderne të komunikimit

Rekomandohet që gjykatat të forcojnë praninë e tyre në rrjetet sociale përmes përmbajtjes profesionale dhe të moderuar, si njoftime, informacione shpjeguese dhe aktivitete institucionale. Për këtë qëllim, KLGJ duhet të hartojë një udhëzues për komunikimin digjital, që përcakton:

- tonin institucional dhe standardet gjuhësore;
- procedurat e verifikimit të informacionit para publikimit;
- mënyrat e reagimit në rast të dezinformimit ose keqkuptimeve publike.

Gjithashtu, faqet zyrtare të gjykatave duhet të kenë më aktive rubrikën e dedikuar "Njoftime për Median", e cila nevojitet të përmbajë njoftime për shtyp, materiale vizuale, kalendarë aktivitetesh dhe njoftime të tjera të ngjashme.

6. Rritja e koordinimit ndërmjet gjykatave dhe KLGJ-së

Rekomandohet që KLGJ të krijojë një mekanizëm të përhershëm koordinimi mediatik me gjykatat, me qëllim sinkronizimin e njoftimeve dhe shmangien e mesazheve të paunifikuara. Ky mekanizëm duhet të përfshijë:

- mbledhje periodike të personave përgjegjës për komunikimin dhe transparencën, për harmonizim të qasjeve dhe shkëmbim të praktikave;
- një platformë/rubrikë të përbashkët për publikimet mediatike, ku çdo gjykatë të ngarkojë njoftime, komunikata dhe materialet informuese;
- mekanizma të brendshëm sigurimi cilësie për të garantuar koherencë në komunikimin publik në nivel kombëtar.

Ky koordinim rrit efektivitetin e komunikimit dhe ndihmon në krijimin e një identiteti të unifikuar komunikues për sistemin gjyqësor.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

7. Menaxhimi i krizave dhe transparenca gjatë çështjeve të ndjeshme

Rekomandohet që çdo gjykatë të ketë një protokoll të qartë reagimi për situatat e ndjeshme ose rastet me interes të lartë publik. Ky protokoll duhet të përcaktojë:

- hapat e menjëhershëm të reagimit institucional;
- rolet e zyrtarëve të autorizuar për komunikim;
- mënyrat e verifikimit të fakteve para publikimit të informacionit.

Reagimet duhet të jenë të shpejta, të sakta dhe të komunikohen vetëm nga personat e autorizuar. KLGJ duhet të ofrojë mbështetje qendrore për koordinimin e mesazheve në situata krize, duke siguruar koherencë dhe qartësi komunikimi. Parimi udhëheqës duhet të jetë: transparencë me përgjegjësi, duke shmangur si heshtjen, ashtu edhe publikimin e informacionit të pasaktë.

8. Edukimi dhe ndërveprimi me publikun

Rekomandohet që gjykatat të marrin një rol më aktiv në edukimin ligjor dhe ndërgjegjësimin publik, përmes iniciativave që shpjegojnë rolin e drejtësisë dhe kufijtë e ndërhyrjes mediatike në proceset gjyqësore. Për këtë qëllim, gjykatat mund të organizojnë:

- aktivitete “Ditët e Hapura” me pjesëmarrjen e studentëve, gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile;
- sesione informuese për publikun dhe grupet e interesit;
- aktivitete bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet arsimore.

Paralelisht, KLGJ mund të zhvillojë fushata kombëtare edukimi gjyqësor, duke përdorur materiale vizuale, udhëzime dhe mesazhe të qarta mbi të drejtat, përgjegjësitë dhe funksionin e gjykatave në sistemin demokratik.

Përmbledhje: Komunikimi me publikun dhe median

1. Komunikimi gjyqësor mbetet i fragmentuar dhe pa strategji të unifikuar.
2. Roli i gjyqtarit për median dhe zyrtarit të komunikimit është ende pasiv.
3. Mungojnë udhëzues standardë dhe procedura të qarta komunikimi.
4. Gjykatat veprojnë kryesisht reaktivisht, jo me qasje proaktive ndaj publikut.
5. Përdorimi i kanaleve moderne dhe mjeteve digjitale është minimal.
6. Nevojitet koordinim më i mirë, menaxhim krizash dhe edukim publik i strukturuar.

KULTURA INSTITUCIONALE E TRANSPARENCËS

Kultura institucionale e transparencës

Përmbajtja dhe rëndësia

Transparenca nuk është vetëm detyrim ligjor apo procedurë administrative; ajo përfaqëson një kulturë institucionale të hapjes, përgjegjshmërisë dhe ndërtimit të besimit publik. Nëse kultura e brendshme institucionale nuk e mbështet, edhe strukturat më të avancuara organizative dhe teknologjike mbeten formale dhe pa efekt të plotë. Të dhënat e vlerësimit tregojnë se në një pjesë të gjykatave transparenca perceptohet ende si detyrim burokratik, jo si vlerë e brendshme që forcon integritetin dhe legjitimitetin e drejtësisë.

1. Transparenca shihet si detyrim formal, jo si parim institucional

Evidentohet se transparenca zbatohet kryesisht për të përmbushur kërkesat ligjore, pa u trajtuar si pjesë përbërëse e identitetit dhe administrimit institucional. Programet e transparencës publikohen, por rrallëherë përdoren si instrument planifikimi, monitorimi apo vetëvlerësimi. Në shumë raste:

- dokumentet përgatiten vetëm kur kërkohen nga KLGJ apo aktorë të jashtëm;
- mungon analiza mbi ndikimin e transparencës në perceptimin publik;
- transparenca nuk lidhet drejtpërdrejt me performancën apo me rritjen e besimit tek gjykata.

Kjo tregon se transparenca nuk është ende e brendësuar në kulturën organizative si parim udhëheqës.

2. Mungesë vizioni të përbashkët brenda stafit për rëndësinë e transparencës

Rezulton se një pjesë e stafit administrativ dhe gjyqësor nuk e konsideron transparencën si detyrë funksionale të përbashkët. Shpesh, ajo perceptohet si përgjegjësi vetëm e koordinatorit apo e zyrtarit të komunikimit, duke mos u njohur karakteri i saj ndërsektorial. Në disa gjykata vërehet:

- mungesë bashkëpunimi mes sektorëve juridik, IT, PR dhe kancelarisë;
- mungesë ndërgjegjësimi mbi rolin e transparencës në cilësinë e shërbimit publik;
- qasje e fragmentuar ndaj përditësimeve dhe publikimeve.

Kjo situatë e zhvendos transparencën nga një objektiv kolektiv në një proces individual.

3. Roli i drejtuesve të gjykatave ende i kufizuar në nxitjen e transparencës

Drejtuesit e gjykatave kanë rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës së transparencës, por përfshirja e tyre në praktikë mbetet e kufizuar. Analiza tregon se shpesh:

- detyrimet delegohen plotësisht te stafi administrativ;
- ndjekja e rregullt e përditësimeve dhe e cilësisë së publikimeve është e kufizuar;
- mungon komunikimi publik i strukturuar, si deklarata vjetore ose mesazhe informuese.

Në disa raste pozitive, përmirësimet janë rezultat i iniciativës dhe angazhimit personal të drejtuesit, duke treguar se nxitja e kulturës së transparencës ende varet më shumë nga individët sesa nga një mekanizëm i konsoliduar institucional.

Kultura institucionale e transparencës

4. Mungesë praktike të vlerësimit të brendshëm institucional

Gjykatat rrallë kryejnë vlerësim të brendshëm mbi efektivitetin e transparencës së tyre. Aktualisht mungojnë instrumentet për:

- vetëvlerësim të rregullt të përmbajtjes së faqes zyrtare;
- mbledhje të reagimeve nga publiku dhe përdoruesit e shërbimeve gjyqësore;
- diskutime të brendshme mbi cilësinë e komunikimit institucional.

Në shumë raste, vetëm projektet e jashtme kanë krijuar momente reflektimi mbi transparencën, duke treguar mungesën e një cikli të qëndrueshëm të të mësuarit institucional. Si rezultat, transparenca parë si proces që duhet të evoluojë në kohë, ende nuk mbështetet nga mekanizma vlerësimi të brendshëm.

5. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit etik mbi të drejtën e publikut për informacion

Rezulton se kërkesat për informacion shpesh perceptohen si presion, ndërsa publikimi i dokumenteve si risk institucional. Kjo tregon mungesë qartësie mbi kufijtë midis transparencës dhe konfidencialitetit, si dhe nevojë për udhëzime të harmonizuara. Në një pjesë të gjykatave mungon:

- përcaktimi i qartë i informacionit që mund të publikohet;
- orientimi mbi mbrojtjen e të dhënave personale;
- udhëzimi praktik për të ruajtur balancën me parimin e pavarësisë gjyqësore.

Kjo pasiguri e shtyn stafin të preferojë mosveprimin si qasje “më të sigurt”, duke kufizuar hapjen institucionale dhe duke dobësuar zbatimin e të drejtës së publikut për informacion.

6. Varësi nga projekte të jashtme për promovimin e transparencës

Në mungesë të strategjive dhe mekanizmave të brendshëm, shumë përmirësime në transparencë kanë ardhur si rezultat i programeve të partnerëve ndërkombëtarë dhe organizatave vendore. Edhe pse këto ndërhyrje kanë sjellë praktika pozitive, ato shpesh nuk janë institucionalizuar. Me përfundimin e projekteve, një pjesë e praktikave nuk vazhdojnë në mënyrë të qëndrueshme. Kjo tregon se kultura e transparencës nuk është ende plotësisht e integruar në sistemin e vetëqeverisjes së gjyqësorit.

7. Mungesë mekanizmash për shpërblim apo nxitje të praktikave pozitive

Asnjë gjykatë nuk ka mekanizma të brendshëm që të njohin, vlerësojnë apo shpërblejnë praktikat pozitive në transparencë, qoftë në nivel stafi apo institucioni. Po ashtu, mungon një sistem krahasues kombëtar që të evidentojë dhe promovojë gjykatat që aplikojnë standarde më të avancuara të hapjes. Në mungesë të nxitjeve, edhe gjykatat me performancë më të mirë nuk kanë motivim të shtuar për të ndarë përvojat apo për të shërbyer si modele, duke kufizuar përhapjen e praktikave të mira.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Ndërtimi i një filozofie të përbashkët të transparencës gjyqësore

Për të forcuar transparencën gjyqësore, është e nevojshme të përcaktohen parime të qarta udhëheqëse që orientojnë mënyrën se si institucionet komunikojnë me publikun dhe administrojnë informacionin.

Parime si saktësia, paanësia dhe integriteti duhet të jenë të pranishme në çdo aspekt të informimit publik, duke siguruar që transparenca të mos mbetet formale, por të shndërrohet në praktikë të qëndrueshme institucionale.

Këto parime ndihmojnë në krijimin e një kulture të përbashkët që promovon besimin, kuptueshmërinë dhe përgjegjshmërinë në sistemin gjyqësor.

2. Rritja e rolit udhëheqës të drejtuesve të gjykatave në transparencë

Drejtuesit e gjykatave kanë rol qendror në orientimin e praktikave të transparencës dhe në garantimin e funksionimit të saj efektiv. Rekomandohet që:

- drejtuesit të publikojnë një përmbledhje vjetore të punës së gjykatës ose një mesazh institucional mbi performancën dhe prioritetet;
- të marrin rol aktiv në hartimin, miratimin dhe monitorimin e programeve të transparencës;
- transparenca të jetë pjesë e diskutimeve të brendshme, të raportimit vjetor dhe të planifikimit organizativ.

Kjo qasje forcon përgjegjshmërinë e nivelit drejtues dhe siguron që transparenca të integrohet në qeverisjen e brendshme të gjykatës, jo të mbetet proces i kufizuar në nivel administrativ.

3. Zhvillimi i trajnimeve mbi kulturën e transparencës dhe etikën institucionale

Megjithëse ekzistojnë trajnime të ofruara nga Shkolla e Magjistraturës dhe institucionet partnere, ato mbeten të pjesshme dhe jo të harmonizuara në nivel sistemi. Për këtë arsye, nevojitet që trajnimi mbi transparencën, komunikimin institucional dhe etikën publike të bëhet pjesë e qëndrueshme dhe e standardizuar e formimit profesional. Rekomandohet që programet:

- të institucionalizohen si module të rregullta për gjyqtarët, drejtuesit dhe stafin administrativ;
- të trajtojnë qartë balancën mes transparencës dhe konfidencialitetit;
- të përditësohen me standardet dhe praktikat evropiane në fushën e komunikimit publik;
- të krijojnë një qasje të unifikuar mbi rolin e çdo aktori në sigurimin e hapjes dhe përgjegjshmërisë.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të brendshëm të gjykatës

Për të kaluar nga praktikat individuale në një qasje të koordinuar institucionale, rekomandohet vendosja e mekanizmave të përhershëm të bashkërendimit të brendshëm. Çdo gjykatë mund të:

- krijojë një grup pune të transparencës, me përfaqësues nga IT, kancelaria, PR dhe sekretaria;
- zhvillojë mbledhje të përmuajshme për të shqyrtuar ecurinë e publikimeve, sfidat dhe nevojat për përmirësim;
- dokumentojë diskutimet dhe vendimmarrjet përmes procesverbaleve të brendshme.

Kjo qasje forcon bashkëpunimin ndërsektorial dhe krijon përgjegjësi të përbashkët për cilësinë e transparencës institucionale.

5. Vendosja e një mekanizmi të vetëvlerësimit të transparencës

Për të matur performancën dhe për të identifikuar përmirësime të nevojshme, rekomandohet krijimi i një formulari të vetëvlerësimit të transparencës, të bazuar në indikatorët e scorecard-it. Formulari duhet:

- të plotësohet çdo gjashtë muaj nga grupi i transparencës;
- të masë nivelin e përditësimit të faqeve, cilësinë e përmbajtjes dhe koherencën e publikimeve;
- të evidentojë mangësitë dhe praktikat pozitive;
- të dërgohet tek KLGJ për analizë krahasuese.

Ky mekanizëm e shndërron transparencën në një proces të vazhdueshëm vlerësimi dhe përmirësimi, të integruar në menaxhimin institucional.

6. Formalizimi i reagimit dhe komenteve nga publiku

Rekomandohet krijimi i një mekanizmi të thjeshtë online për mbledhjen e komenteve të publikut mbi cilësinë dhe qartësinë e informacionit të publikuar. Ky sistem duhet të:

- regjistrojë pyetjet dhe sugjerimet e paraqitura nga qytetarët;
- analizojë temat më të përsëritura;
- gjenerojë përmbledhje tremujore për grupin e transparencës.

Përmes këtij mekanizmi, qytetarët marrin një rol aktiv në procesin e transparencës dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e tij.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

7. Integrimi i transparencës në vlerësimin institucional dhe etik

KLGJ mund të përfshijë transparencën si komponent të posaçëm në vlerësimin e performancës së gjykatave dhe drejtuesve. Kjo mund të përfshijë:

- tregues të matshëm mbi përditësimin dhe cilësinë e publikimeve në raportet vjetore;
- vlerësimin e angazhimit të drejtuesit në komunikimin publik dhe menaxhimin e transparencës;
- referenca nga auditimet e KLGJ-së mbi zbatimin e standardeve.

Kjo qasje forcon motivimin institucional dhe e lidh transparencën me përgjegjshmërinë profesionale dhe integritetin administrativ.

8. Krijimi i një rrjeti praktikash pozitive ndërmjet gjykatave

Rekomandohet krijimi i një platforme bashkëndarjeje ("Judicial Transparency Hub"), ku gjykatat mund të:

- publikojnë shembuj praktikash të suksesshme, si buletine, materiale informuese ose formate standarde;
- ndajnë dokumente model dhe udhëzime teknike;
- bashkëpunojnë për përditësimin e standardeve dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta.

Kjo platformë nxit shkëmbimin horizontal të përvojave dhe mbështet një qasje uniforme në gjithë sistemin gjyqësor.

9. Integrimi i transparencës në strategjitë e komunikimit të gjykatave

Çdo gjykatë duhet të hartojë një plan komunikimi vjetor, i cili përfshin:

- temat dhe përmbajtjet prioritare për publikim, si veprimtari, statistika dhe informacion administrativ;
- formatet dhe afatet e njoftimeve;
- përgjegjësit për përgatitjen dhe publikimin e informacionit.

Plani duhet të jetë pjesë e Programit të Transparencës dhe të synojë harmonizimin e komunikimit publik me objektivat institucionale dhe rritjen e besueshmërisë së gjykatës.

Përmbledhje: Kultura institucionale e transparencës

1. Transparenca kërkon brendësim kulturor dhe nuk mund të qëndrojë vetëm si detyrim formal.
2. Stafi dhe drejtuesit duhet të ndajnë një vizion të përbashkët mbi rëndësinë e hapjes institucionale.
3. Përfshirja aktive e drejtuesve është thelbësore për krijimin e një klime të qëndrueshme transparence.
4. Vetëvlerësimi i rregullt institucional ndihmon në identifikimin e mangësive dhe praktikave të mira.
5. Etika profesionale dhe kuptimi i të drejtës për informacion janë ende të paqarta në shumë gjykata.
6. Transparenca duhet të kthehet në proces kolektiv, të mbështetur nga bashkëpunimi i brendshëm dhe nga KLGJ.

TRANSPARENCA NË VENDIMMARRJEN GJYQËSORE DHE AKSESI NË VENDIME

Transparenca në vendimmarrjen gjyqësore dhe aksesi në vendime

Përmbajtja dhe rëndësia

Transparenca në vendimmarrjen gjyqësore përbën një element themelor të shtetit të së drejtës. Megjithatë, të dhënat tregojnë se transparenca në publikimin e vendimeve gjyqësore në Shqipëri mbetet e fragmentuar, jo e unifikuar dhe shpesh formale, me diferenca të ndjeshme ndërmjet niveleve gjyqësore.

1. Mospërputhje ndërmjet detyrimeve ligjore dhe praktikës

Kuadri ligjor dhe aktet nënligjore të KLGJ-së kërkojnë publikimin e vendimeve gjyqësore në formë të anonimizuar. Në praktikë, një numër i konsiderueshëm gjykatash:

- nuk publikojnë vendime në faqet e tyre zyrtare;
- i transmetojnë me vonesë;
- ose publikojnë vetëm një numër të kufizuar vendimesh.

Në disa raste, publikimi kryhet vetëm për çështje me interes të lartë publik, gjë që tregon mungesë të një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të detyrueshëm për publikim të plotë, të rregullt dhe gjithëpërfshirës.

2. Mungesë uniformiteti në mënyrën e anonimizimit

Një sfidë e vazhdueshme është mungesa e standardeve të unifikuara për anonimizimin e vendimeve. Praktikat ndryshojnë ndjeshëm ndërmjet gjykatave:

- disa ndërhyjnë manualisht në dokumente Word;
- disa përdorin iniciale të ndryshme ose kode jo të harmonizuara;
- disa thjesht heqin emra pa vendosur shenja zëvendësuese.

Kjo krijon rrezik për gabime, cënim të të dhënave personale dhe mungesë koherence ndërmjet vendimeve të anonimizuara. Përdorimi i metodave manuale, pa softuer ose protokoll të përbashkët, e bën procesin të ngadaltë, jo të standardizuar dhe të pambështetur në garanci të mjaftueshme teknike.

3. Pabarazi ndërmjet niveleve të gjykatave në aksesin publik

Ekziston një diferencë e dukshme në nivelin e transparencës së vendimeve gjyqësore midis niveleve dhe strukturave të ndryshme të sistemit. Ndërsa disa gjykata kanë mekanizma funksionalë për publikimin dhe kërkimin e vendimeve, në shumë raste:

- publikohen vetëm informacione të përgjithshme procedurale, pa akses të plotë në vendimet përfundimtare;
- rubrikat e dedikuara për vendimet janë të papërditësuara ose të paoperacionalizuara;
- mungojnë mjete kërkimi që të lejojnë orientimin sipas datës, llojit të çështjes apo trupës gjykuese.

Këto mospërputhje krijojnë pabarazi në aksesin e publikut ndaj jurisprudencës, e cila është thelbësore për kuptimin e praktikës gjyqësore dhe konsolidimin e transparencës institucionale. Rezultati përfundimtar është një panoramë e fragmentuar dhe jo e unifikuar e vendimmarrjes gjyqësore në nivel kombëtar.

Transparenca në vendimmarrjen gjyqësore dhe aksesi në vendime

4. Mungesë lidhjeje midis vendimeve dhe sistemeve qendrore të informacionit

Transparenca në publikimin e vendimeve pengohet nga mungesa e një platforme të centralizuar kombëtare, e cila do të siguronte një proces të unifikuar dhe të automatizuar. Aktualisht, gjykatat nuk operojnë brenda një sistemi të përbashkët për publikimin e vendimeve, çka sjell:

- mungesë sinkronizimi ndërmjet vendimeve të shpallura dhe publikimeve zyrtare;
- pamundësi për kërkim të centralizuar nga publiku dhe profesionistët;
- arkivim të fragmentuar dhe jo të standardizuar të jurisprudencës.

5. Përmbajtje të kufizuara dhe jo të strukturuara të vendimeve të publikuara

Shumë nga vendimet e publikuara nuk përmbushin standardet minimale të aksesueshmërisë dhe të strukturimit teknik. Problematikat më të shpeshta përfshijnë:

- mungesë të elementeve të plotë të arsyetimit juridik;
- publikime në formate të pakërkueshme (p.sh. dokumente të skanuara pa tekst digjital);
- mungesë të metadatave thelbësore si data e shpalljes, numri i çështjes, përmbajtja ligjore ose trupa gjykuese.

6. Transparencë e pjesshme dhe mungesë informacioni mbi shkallën e publikimit

Megjithëse vendimet gjyqësore publikohen në shumë raste, publikimi mbetet i pjesshëm dhe pa një strukturë raportimi që të pasqyrojë panoramën reale të transparencës. Aktualisht, ka mangësi në të dhëna të plota mbi:

- numrin total të vendimeve të dhëna në vit nga çdo gjykatë;
- numrin e vendimeve të publikuara dhe përqindjen që ato përfaqësojnë;
- kategoritë e vendimeve që publikohen më shpesh ose që mungojnë;
- arsyet e mos-publikimit të vendimeve të caktuara (p.sh. çështje të ndjeshme, kufizime ligjore, standarde të mbrojtjes së të dhënave).

7. Pasiguri ligjore dhe frikë nga ekspozimi publik

Një pjesë e gjykatave shprehin pasiguri mbi kufirin midis transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo paqartësi normative, e kombinuar me frikën nga keqinterpretimi publik ose presioni mediatik, sjell:

- publikim të kufizuar përtej detyrimeve minimale;
- vetë-censurë institucionale;
- shmangie të publikimit të vendimeve që perceptohen si të ndjeshme.

8. Përdorim minimal i vendimeve për edukim publik dhe juridik

Vendimet gjyqësore nuk shfrytëzohen në mënyrë të strukturuar për edukim publik ose juridik. Aktualisht mungojnë:

- përmbledhjet e thjeshtuara të vendimeve me gjuhë të qartë;
- analizat tematike të jurisprudencës;
- materiale interpretative ose vizuale për publikun e gjerë.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Krijimi i një platforme të unifikuar për publikimin e vendimeve gjyqësore

Rekomandohet ngritja e një platforme të unifikuar, nën administrimin e KLGJ-së, e cila të shërbejë si pikë qendrore për publikimin e të gjitha vendimeve gjyqësore në nivel kombëtar. Kjo platformë duhet të:

- integrojë vendimet e të gjitha niveleve gjyqësore në një hapësirë të vetme të aksesueshme publikisht;
- ofrojë motor kërkimi të unifikuar sipas gjykatës, llojit të çështjes, datës, trupës gjykuese ose fjalëve kyçe;
- mundësojë publikim automatik të vendimeve nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve (ICMIS);
- sigurojë anonimizim të standardizuar përmes protokolleve të përbashkëta.

Krijimi i kësaj platforme do të minimizojë fragmentimin aktual dhe do të garantojë akses të barabartë dhe të besueshëm për publikun, profesionistët dhe institucionet.

2. Krijimi i mekanizmit automatik për publikimin e vendimeve

Për të siguruar publikim në kohë dhe të qëndrueshëm, rekomandohet lidhja funksionale e ICMIS me platformën kombëtare të vendimeve. Kjo ndërveprim do të mundësojë që:

- vendimi i nënshkruar elektronikisht të ngarkohet automatikisht në platformë;
- procesi i anonimizimit të realizohet përmes softuerit të integruar, sipas standardeve të miratuara;
- të gjenerohen automatikisht metadata për çdo vendim (data e shpalljes, numri i çështjes, lloji i vendimit, gjykata, gjyqtari raportues).

Ky mekanizëm ul ndërhyrjet manuale, rrit saktësinë teknike dhe eliminon vonesat, duke garantuar publikim sistematik dhe të automatizuar.

3. Vendosja e treguesve të transparencës për publikimin e vendimeve

KLGJ duhet të përcaktojë dhe monitorojë tregues të qartë për transparencën në vendimmarrje, duke siguruar vlerësim të matshëm dhe të krahasueshëm. Ndër treguesit e rekomanduar janë:

- përqindja e vendimeve të publikuara ndaj numrit total të vendimeve të dhëna;
- koha mesatare midis shpalljes dhe publikimit;
- përqindja e vendimeve të anonimizuara;
- shkalla e përdorimit të metadatave standarde.

Raportimi periodik, të paktën çdo gjashtë muaj, do të lejojë monitorim të vazhdueshëm të progresit dhe identifikim të boshllëqeve për përmirësim.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Krijimi i një rubrike të detajuar për vendimet në faqet e gjykatave

Nevojitet që çdo gjykatë duhet të sigurojë një rubrikë të dedikuar për publikimin e vendimeve, e strukturuar sipas llojit të çështjeve dhe kategorive procedurale. Kjo rubrikë duhet të:

- përfshijë publikimin e vendimeve me relevancë të lartë institucionale ose me ndikim publik;
- shënojë qartë datën e publikimit dhe elementët kryesorë të arsyetimit;
- ruajë një arkiv elektronik me versionet paraprake, duke garantuar gjurmueshmëri dhe integritet dokumentar.

Kjo qasje forcon profilin e gjykatës në drejtim të transparencës dhe u mundëson përdoruesve qasje më të strukturuar në jurisprudencën vendore.

5. Krijimi i një moduli për analizën tematike të vendimeve

Rekomandohet që KLGJ të zhvillojë një modul analitik që klasifikon vendimet gjyqësore sipas temave ligjore dhe fushave të specializimit (si p.sh. të drejtat e njeriut, çështjet administrative, çështjet penale, çështjet civile). Ky modul do të mundësojë:

- analizë statistikore të praktikës gjyqësore në nivel kombëtar;
- identifikim të tendencave në interpretimin e normave;
- përdorim më efikas të vendimeve nga profesionistët, studiuesit dhe publiku i interesuar.

Kjo i jep jurisprudencës një dimension shtesë njohjeje dhe e rrit vlerën e saj si burim edukimi juridik.

6. Edukimi publik mbi rolin dhe leximin e vendimeve

Transparenca e vendimmarrjes nuk mjafton vetëm me publikimin e vendimeve; informacioni duhet të jetë i kuptueshëm për publikun e gjerë. Aktualisht, vendimet publikohen sipas kërkesave ligjore, por mungojnë elemente ndihmëse që e lejojnë qytetarin të kuptojë përmbajtjen dhe logjikën e tyre. Për këtë arsye, rekomandohet që gjykatat të:

- shoqërojnë publikimin e vendimeve me përshkrime shumë të shkurtra orientuese (p.sh. objekti i çështjes dhe faza procedurale), aty ku kjo është e mundur dhe pa cenuar të dhënat personale;
- ofrojnë materiale të thjeshtuara informuese për temat që shkaktojnë më shumë paqartësi te publiku (p.sh. afatet e ankimimit, llojet e vendimeve, dallimi midis pushimit dhe tërheqjes së padisë).

Përmbledhje: Transparenca në vendimmarrjen gjyqësore dhe aksesi në vendime

1. Publikimi i vendimeve mbetet i pjesshëm dhe jo i standardizuar në të gjithë sistemin.
2. Detyrimet ligjore për publikim nuk përputhen plotësisht me praktikën e gjykatave.
3. Proceset e anonimizimit janë të ndryshme dhe shpesh jo të sigurta teknikisht.
4. Aksesi publik në vendimet gjyqësore është i fragmentuar dhe pa funksione të avancuara kërkimi.
5. Vendimet e publikuara shpesh janë të paplota, jo të strukturuara dhe pa metadata shoqëruese.
6. Mungesa e raportimit mbi nivelin real të publikimit kufizon transparencën dhe llogaridhënien.

TRANSPARENCA STATISTIKORE DHE TË DHËNAT MBI PERFORMANCËN

Transparenca statistikore dhe të dhënat mbi performancën

Përmbajtja dhe rëndësia

Transparenca statistikore përbën një element thelbësor të hapjes së sistemit gjyqësor dhe një mekanizëm kyç llogaridhënieje. Ajo reflekton mënyrën se si gjykatat administrojnë ngarkesën, trajtojnë çështjet dhe përdorin burimet publike, duke krijuar mundësi reale për publikun, studiuesit dhe vetë institucionet që të vlerësojnë performancën dhe efikasitetin e drejtësisë. Megjithatë, analiza e të dhënave tregon se transparenca statistikore në gjykatat shqiptare është ende e fragmentuar, e paunifikuar dhe shpesh e vështirë për t'u interpretuar nga publiku.

1. Mungesë publikimi të rregullt të të dhënave statistikore

Në një pjesë të madhe të gjykatave mungon publikimi periodik i statistikave gjyqësore. Rubrikat e dedikuara ose nuk ekzistojnë, ose përmbajnë vetëm raportin vjetor pa ndarje tematike, mujore apo sipas treguesve të ngarkesës. Ku statistikat publikohen, ato shpesh paraqiten si shifra të izoluara, pa analizë shoqëruese, duke pamundësuar identifikimin e trendeve dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancës.

2. Mungesë standardizimi në formatin e të dhënave

Formatet e publikimit ndryshojnë ndjeshëm nga një gjykatë te tjetra. Disa përdorin dokumente statike (Word ose PDF), të tjera përmbledhje narrative, ndërsa shumë pak përdorin formate vizuale ose tregues analitikë. Kjo mospërputhje metodologjike tregon mungesën e një standardi të përbashkët për mbledhjen dhe publikimin e statistikave, duke penguar krahasimin horizontal dhe monitorimin qendror nga KLGJ.

3. Mungesë publikimi të treguesve të performancës

Shumë gjykata kufizohen në publikimin e statistikave sasiore, si numri i çështjeve të regjistruara dhe të përfunduara, pa përfshirë treguesit cilësorë të performancës. Mungojnë të dhëna mbi kohëzgjatjen e çështjeve, ngarkesën për gjyqtar, përqindjen e çështjeve të përfunduara brenda afateve, apo vendimet e ndryshuara në instanca më të larta. Kjo e redukton transparencën në një proces formal, që nuk pasqyron efikasitetin e vërtetë të sistemeve gjyqësore.

4. Të dhëna të shpërndara në burime të ndryshme

Një pjesë e statistikave mund të gjenden në raportet qendrore të KLGJ-së ose në raportimet vjetore të vetë gjykatave, por këto të dhëna shpesh nuk pasqyrohen në faqet e tyre zyrtare. Kjo fragmentim informacioni krijon vështirësi në qasjen e publikut dhe pengon krijimin e një panorame të unifikuar të performancës gjyqësore. Në praktikë, kjo dobësON transparencën institucionale dhe e kufizon përdorimin e statistikave për analiza të thelluara dhe monitorim publik.

Transparenca statistikore dhe të dhënat mbi performancën

5. Pamundësi për analizë krahasuese ndërvite

Një problem i përsëritur është mungesa e ruajtjes së historikut shumëvjeçar të statistikave në faqet zyrtare të gjykatave. Shpesh publikohet vetëm viti aktual ose raporti vjetor, pa arkiv të strukturuar për periudhat e mëparshme. Në kushtet kur të dhënat nuk ruhen në mënyrë të vazhdueshme dhe të aksesueshme, bëhet e pamundur analizimi i zhvillimeve në kohë, identifikimi i trendeve apo vlerësimi i progresit afatgjatë të performancës gjyqësore. Kjo e kufizon transparencën në një moment të vetëm, pa e lidhur me efikasitetin historik të institucionit.

6. Përdorim i kufizuar i vizualizimeve dhe grafikëve

Shumica e të dhënave statistikore paraqiten në formate të thata, kryesisht tabela ose dokumente tekstuale, pa shoqërim me grafika apo interpretime vizuale. Mungojnë vizualizimet që do të mundësonin lexim të shpejtë të treguesve, si p.sh. krahasimet e çështjeve hyrëse dhe të përfunduara, ngarkesa për gjyqtar apo kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit. Kjo e kufizon transparencën vetëm për përdoruesit me ekspertizë të avancuar, ndërsa e bën të vështirë për qytetarët dhe publikun e gjerë të kuptojnë gjendjen dhe dinamikën e performancës së gjykatave.

7. Mungesë bashkërendimi me KLGJ për raportimin standard

Megjithëse KLGJ ka miratuar disa formate të unifikuara raportimi që përdoren nga të gjitha gjykatat (veçanërisht për statistikat, treguesit vjetorë dhe të dhënat administrative), këto standarde nuk reflektohen në mënyrë të qëndrueshme në faqet zyrtare të gjykatave. Në nivel online, statistikat publikohen me struktura të ndryshme, në formate jo të krahasueshme ose pa koherencë me raportimet zyrtare të KLGJ-së. Mungon gjithashtu një protokoll digjital për harmonizimin automatik të të dhënave, duke bërë që transparenca të mbetet fragmentare dhe e pakoordinuar vertikalisht, pavarësisht ekzistencës së modeleve të përbashkëta të raportimit.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Krijimi i sistemit të unifikuar për raportimin statistik gjyqësor

Rekomandohet ngritja e një platforme të centralizuar kombëtare për statistikat gjyqësore, nën administrimin e KLGJ-së, e cila:

- mbledh automatikisht të dhënat nga të gjitha gjykatat përmes sistemeve digjitale aktuale;
- i shfaq publikisht në kohë reale përmes një ndërfaqeje transparente ("Open Justice Dashboard");
- mundëson krahasime ndërvite dhe ndërmjet gjykatave, duke krijuar një pamje të unifikuar të performancës gjyqësore.

Ky sistem do të adresojë fragmentimin ekzistues, duke siguruar monitorim të qëndrueshëm dhe qasje të barabartë në të dhëna.

2. Përcaktimi i treguesve standardë të performancës gjyqësore

KLGJ nevojitet të miratojë një set të standardizuar treguesish (KPIs), të detyrueshme për çdo gjykatë, që përfshin:

- numrin e çështjeve të regjistruara, të trajtuara dhe të mbetura;
- kohëzgjatjen mesatare të shqyrtimit;
- ngarkesën për gjyqtar;
- përqindjen e çështjeve të përfunduara brenda afateve ligjore;
- numrin e vendimeve të prishura në apel;
- tregues financiarë bazë (shpenzime, buxhet për personel).

Standardizimi i këtyre treguesve siguron matje të krahasueshme, vlerësim objektiv të performancës dhe harmonizim të transparencës ndërmjet gjykatave.

3. Publikimi periodik i të dhënave në format të hapur

Çdo gjykatë duhet të publikojë statistika:

- mujore,
- tremujore,
- vjetore,

në formate të hapura (CSV, XLSX, HTML), duke garantuar që:

- të dhënat të jenë të aksesueshme dhe të përpunueshme;
- të shmanget publikimi i dokumenteve të mbyllura ose jo të kërkueshme;
- të rritet përdorimi i informacionit për kërkime, monitorim dhe transparencë publike.

Kjo qasje përputhet me praktikat më të mira ndërkombëtare (Open Data Charter, CEPEJ) dhe rrit vlerën e të dhënave statistikore për publikun e gjerë.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Integrimi i vizualizimeve dinamike në faqet e gjykatave

Rekomandohet që faqet zyrtare të gjykatave të përfshijnë vizualizime dinamike të të dhënave, përmes grafikëve dhe tabelave interaktive, si:

- grafikë të hyrje-daljeve të çështjeve sipas muajve;
- paraqitje vizuale të kohëzgjatjes mesatare të shqyrtimit;
- përqindjen e çështjeve të zgjidhura brenda afateve;
- krahasime ndërvite sipas treguesve kryesorë të performancës.

Këto vizualizime rrisin qartësinë dhe aksesueshmërinë e informacionit, duke e bërë transparencën statistikore më të kuptueshme dhe më të përdorshme për publikun.

5. Lidhja e statistikave me buxhetin dhe burimet

Rekomandohet që gjykatat të publikojnë tregues që lidhin performancën gjyqësore me burimet financiare dhe njerëzore, si:

- kostoja mesatare për çështje të trajtuar;
- raporti ndërmjet çështjeve të përfunduara dhe numrit të stafit gjyqësor/administrativ;
- përqindja e buxhetit të alokuar për shërbime, logjistikë dhe teknologji të informacionit.

Këto tregues krijojnë një formë transparence fiskale të lidhur drejtpërdrejt me efikasitetin institucional, duke i mundësuar publikut të kuptojë se si përdoren burimet për të garantuar drejtësi efektive.

6. Vendosja e një standardi për ruajtjen e historikut shumëvjeçar

Këshillohet vendosja e një standardi të unifikuar për arkivimin e statistikave gjyqësore, ku çdo gjykatë të ruajë një historik të paktën 5-vjeçar me të njëjtët tregues performance. Arkiva duhet të sigurojë:

- analizë të qëndrueshme të trendeve afatgjata;
- vlerësim të progresit ose sfidave institucionale;
- bazë për auditime, planifikim dhe politikëbërje të informuar.

Historiku duhet të jetë i kërkueshëm sipas vitit dhe llojit të çështjes, në formate të hapura dhe të përputhshme me standardet e Open Data.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

7. Krijimi i një modeli krahasues ndërmjet gjykatave ("Benchmarking")

Rekomandohet që KLGJ të zhvillojë dhe publikojë çdo vit një raport krahasues të performancës së gjykatave, bazuar në treguesit standardë të transparencës statistikore. Ky raport mund të përdorë një sistem vizual vlerësimi (p.sh. jeshile = performancë e lartë, verdhë = mesatare, kuqe = nën standard), duke mundësuar:

- identifikimin e praktikave më të mira në nivel kombëtar;
- nxitjen e konkurrencës pozitive ndërmjet gjykatave;
- shndërrimin e transparencës në mekanizëm motivues dhe zhvillimor;
- forcimin e llogaridhënies përmes monitorimit nga publiku, media dhe aktorët e tjerë institucionalë.

Ky model benchmarking e kthen transparencën statistikore në instrument menaxhimi dhe mirëqeverisjeje.

8. Përmirësimi i bashkërendimit me KLGJ dhe njësitë e statistikave

Për të siguruar cilësi dhe koherencë të të dhënave statistikore, rekomandohet vendosja e një mekanizmi të rregullt raportimi midis çdo gjykate dhe sektorit të statistikave në KLGJ. Ky mekanizëm synon të:

- standardizojë mbledhjen, përpunimin dhe verifikimin e të dhënave;
- parandalojë gabimet numerike ose mospërputhjet midis burimeve;
- mundësojë auditim të përbashkët të cilësisë së të dhënave;
- garantojë përputhjen e plotë me metodologjinë kombëtare të raportimit.

Në këtë mënyrë, KLGJ forcon rolin e tij si koordinator teknik dhe garant i integritetit të statistikave gjyqësore.

9. Përfshirja e të dhënave në komunikimin publik

Për të rritur transparencën dhe kuptueshmërinë publike, rekomandohet që gjykatat dhe KLGJ të integrojnë të dhënat statistikore në komunikimin e tyre publik, përmes:

- përfshirjes së grafikëve dhe treguesve kryesorë në njoftimet dhe raportet vjetore;
- përgatitjes së infografikëve dhe materialeve vizuale të aksesueshme për qytetarët;
- shpjegimit të statistikave në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke treguar qartë se çfarë sinjalizojnë ato për punën dhe performancën e gjykatës.

Kjo qasje ndihmon në demistifikimin e të dhënave, rrit ndërgjegjësimin e publikut dhe e lidh drejtpërdrejt performancën gjyqësore me perceptimin e qytetarëve.

Përmbledhje: Transparenca statistikore dhe të dhënat mbi performancën

1. Transparenca statistikore kërkon standarde të unifikuara dhe publikim të rregullt.
2. Mungesa e formatit të përbashkët e pengon krahasimin ndërmjet gjykatave.
3. Treguesit e performancës duhet të publikohen në mënyrë të hapur dhe periodike.
4. Vizualizimet dinamike rrisin qartësinë dhe aksesin e publikut.
5. Bashkërendimi me KLGJ garanton cilësi dhe koherencë të të dhënave.
6. Integrimi i statistikave në komunikimin publik forcon llogaridhënien.

SHËRBIMET PËR PUBLIKUN DHE AKSESUESHMËRIA

Shërbimet për publikun dhe aksesueshmëria

Përmbajtja dhe rëndësia

Aksesueshmëria dhe shërbimet për publikun përbëjnë dimensionin më të dukshëm të transparencës gjyqësore. Ato përcaktojnë se sa lehtë qytetari mund të gjejë, kuptojë dhe përdorë informacionin publik të gjykatës, si dhe nëse sistemi ofron mbështetje të qartë dhe miqësore për kërkesat e tij.

Në praktikë, këto elemente përkthejnë parimet e transparencës institucionale në përvojën reale të përdoruesit. Gjetjet e vlerësimit tregojnë se aksesueshmëria e informacionit dhe cilësia e shërbimeve për publikun në gjykatat shqiptare mbeten të fragmentuara, të pabarabarta dhe shpesh të papërshtatura me nevojat e qytetarëve.

1. Përmbajtje e paqartë dhe jo e unifikuar në faqet zyrtare

Përmbajtja e faqeve zyrtare të gjykatave nuk ndjek standarde të përbashkëta institucionale, duke sjellë ndryshime të ndjeshme në mënyrën e prezantimit, hierarkisë dhe qartësisë së informacionit. Informacionet kryesore shpesh paraqiten në mënyrë të pjesshme, me terminologji të ndryshme nga gjykata në gjykatë, dhe pa një logjikë të unifikuar që lehtëson orientimin e publikut. Kjo mospërputhje përmbajtësore krijon konfuzion, rrit kohën e kërkimit të informacionit dhe ul transparencën praktike në nivel sistemi.

2. Vështirësi në qasjen gjuhësore dhe vizuale

Vërehet përdorimi i një gjuhe teknike dhe ligjore, që është e vështirë për qytetarët pa njohuri profesionale. Në disa raste mungon shpjegimi praktik i procedurave (p.sh. “si bëhet një kërkesë për informacion”, “si depozitohet një ankesë” etj.). Ndërfaqja vizuale e faqeve shpesh është e ngarkuar, jo intuitive dhe jo miqësore për përdoruesin, sidomos në pajisje mobile. Vetëm pak gjykata ofrojnë udhëzime të thjeshtuara ose video informuese për publikun. Kjo tregon se aspekti i komunikimit publik ende nuk trajtohet si pjesë integrale e transparencës.

3. Mungesë e informacionit të përditësuar për shërbimet ndaj qytetarëve

Edhe kur informacioni publik ekziston, ai shpesh është i shpërndarë në rubrika të ndryshme, pa lidhje logjike ndërmjet tyre dhe pa një strukturë që e konsolidon përmbajtjen në një vend të vetëm. Të dhëna të rëndësishme për qytetarët, si shërbimet, formularët, kontaktet, udhëzimet administrative apo njoftimet, shpesh gjenden të fragmentuara në dokumente të ndryshme, pa datë, pa version dhe pa orientim të qartë. Kjo fragmentarizim e vështirëson aksesin real në informacion dhe krijon boshllëqe në transparencën aktive.

Shërbimet për publikun dhe aksesueshmëria

4. Mospërputhje në nivelin e ofrimit të shërbimeve digjitale

Megjithëse shumica e gjykatave disponojnë module apo instrumente digjitale të parashikuara në modelin standard (si formularë elektronikë, rubrika për kërkesa online ose lidhje me sisteme elektronike), mungon informacion i qartë mbi shkallën e përdorimit të tyre dhe efektshmërinë reale për publikun. Në praktikë, komunikimi vijon të mbështetet kryesisht në paraqitjen fizike ose në dërgimin e kërkesave përmes e-mailit, ndërsa shërbimet digjitale mbeten të pashfrytëzuara ose jo plotësisht funksionale. Po ashtu, në disa raste nuk realizohet integrimi i nevojshëm me portalet kombëtare të drejtësisë apo me sistemet institucionale elektronike, duke krijuar një hendek midis digjitalizimit formal dhe aksesit real të qytetarëve.

5. Mungesë informacioni për grupet vulnerabël dhe personat me nevoja të veçanta

Asnjë nga faqet e analizuara nuk përmban udhëzime konkrete ose rubrika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës apo grupet vulnerabël, megjithëse këto kategori parashikohen qartë në kuadrin ligjor si përfitues të aksesit të shtuar në drejtësi. Po ashtu, faqet nuk janë të përshtatura teknikisht për përdorim me mjete ndihmëse (shfletues me zë, kontrast i rregullueshëm, version “text-only”). Kjo mungesë kufizon aksesin e barabartë në informacion dhe bie ndesh me standardet minimale të transparencës publike.

6. Informacion i shpërndarë dhe jo i lidhur logjikisht

Në shumë raste, informacioni për publikun është i fragmentuar në disa rubrika të ndryshme (“Të dhëna për qytetarët”, “Dokumente”, “Njoftime”, “Programi i transparencës”, etj.), pa një strukturë të organizuar që të lehtësojë orientimin. Kjo shpërndarje e pakordinuar e vështirëson identifikimin e informacionit dhe tregon mungesën e një standardi të përbashkët për administrimin e faqeve zyrtare. Ky boshllëk është një nga aspektet që udhëzuesi synon të adresojë për të rritur qartësinë dhe aksesin publik.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Standardizimi dhe qartësimi i strukturës së faqeve zyrtare

Për të garantuar akses të lehtë dhe informacion të kuptueshëm për publikun, KLGJ duhet të hartojë dhe miratojë një strukturë të unifikuar të faqeve zyrtare të gjykatave, e cila të eliminojë mbivendosjet aktuale dhe terminologjinë e paqartë të rubrikave. Struktura duhet të:

- përcaktojë emërtime standarde dhe unikale për rubrikat kryesore (p.sh. "Njoftime Zyrtare", "Shërbime për Publikun", "Vendime", "Statistika", "Programi i Transparencës"), duke shmangur rubrikat e shumëfishta me funksion të ngjashëm ("Njoftime", "Njoftime për publikun", "Të rejat", etj.);
- organizojë informacionin sipas një logjike të qartë (shërbimet në një seksion; dokumentet zyrtare në një seksion; vendimet në një seksion; transparenca në një seksion të vetëm);
- vendosë renditje të qëndrueshme të menuseve, në mënyrë që përdoruesi të mos kërkojë të njëjtin informacion në disa rubrika të ndryshme;
- sigurojë koherencë vizuale dhe funksionale në të gjitha gjykatat, duke forcuar identitetin institucional dhe orientimin e përdoruesit.

2. Thjeshtimi i gjuhës dhe përmirësimi i ndërfaqes vizuale

- Të përdoret "gjuha e qartë" në shpjegimin e procedurave dhe shërbimeve, duke shmangur zhargonin teknik ose ligjor.
- Për çdo procedurë që kërkon ndërveprim të qytetarit me gjykatën (ankesa, kërkesë për informacion, kërkesë për verifikim vendimi, kërkesë për përjashtim nga tarifa), të hartohen udhëzime të thjeshtuara dhe praktike "Hap pas hapi".
- Të zbatohen standarde të aksesueshmërisë vizuale, përfshirë kontrastin e tekstit, madhësinë e shkronjave, organizimin e qartë të përmbajtjes dhe versionet e optimizuara për pajisje mobile.
- KLGJ të përgatisë modele standarde për rubrikat informuese, me qëllim ruajtjen e uniformitetit në të gjitha gjykatat.

3. Zgjerimi i shërbimeve për publikun në format digjital

- Të mundësohet dorëzimi online i kërkesave dhe ankesave përmes formularëve elektronikë të standardizuar, të hartuar dhe miratuar nga KLGJ.
- Të integrohen lidhje funksionale me portalet kombëtare të drejtësisë, si "e-Albania", "Open Data" dhe platformat elektronike të KLGJ-së, për të thjeshtuar qasjen e qytetarëve.
- Të krijohen harta interaktive të gjykatave me të dhëna praktike mbi vendndodhjen, oraret e shërbimit dhe kontaktet e zyrave përgjegjëse.
- Të pilotohet përdorimi i asistencës virtuale (chatbot) për pyetjet më të shpeshta dhe orientimin fillestar të qytetarëve në procedurat bazë.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Përfshirja e grupeve vulnerabël dhe garantimi i aksesit të barabartë

- Faqet zyrtare të përshtaten për akses universal, duke përfshirë funksione si: lexues elektronikë (screen readers), kontrast të rregullueshëm, version tekstual dhe navigim të thjeshtuar.
- Të krijohen rubrika të dedikuara për viktimat e dhunës, personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarët pa përfaqësim ligjor, me udhëzime të qarta dhe praktike mbi të drejtat, shërbimet dhe mënyrat e kontaktit.
- Të përgatiten materiale informuese të aksesueshme (video, fletëpalosje të thjeshtuara), duke përfshirë përkthime në gjuhë të komuniteteve lokale kur është e nevojshme.

5. Menaxhimi i përditësimeve dhe kontrolli i cilësisë

- Çdo gjykatë të caktojë një person përgjegjës për administrimin e faqes (koordinatori i informacionit ose një zyrtar IT), me detyrë për përditësim të rregullt.
- KLGJ nevojitet të vendosë një mekanizëm verifikimi periodik, p.sh., raportim gjashtëmujor mbi cilësinë, aktualitetin dhe funksionalitetin e faqes.
- Të hartohet një udhëzues praktik për administrimin e faqeve zyrtare, që përcakton standardet teknike dhe përmbajtësë, si dhe procedurat e publikimit.
- Të përcaktohet një set indikatorësh minimalë për cilësinë e faqes, duke përfshirë: frekuencën e përditësimeve, qartësinë e strukturës dhe funksionimin e lidhjeve aktive.

6. Nxitja e ndërveprimit dhe matjes së përvojës së përdoruesit

- Të shtohet në faqet zyrtare një formë e shkurtër “Feedback për faqen”, që u mundëson qytetarëve të raportojnë vështirësi ose të propozojnë përmirësime.
- KLGJ të analizojë rregullisht këto të dhëna për të identifikuar tendencat, nevojat e publikut dhe praktikat e mira ndërgjykata.
- Të përgatitet një raport vjetor për aksesueshmërinë dhe përdorshmërinë e faqeve të gjykatave, si pjesë e mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies publike.

Përmbledhje: Shërbimet për publikun dhe aksesueshmëria

1. Aksesueshmëria e faqeve gjyqësore mbetet e kufizuar, sidomos për përdorues me aftësi të kufizuara.
2. Informacioni për grupet vulnerabël është i mangët dhe shpesh mungojnë udhëzime të dedikuara.
3. Përditësimi i faqeve mbetet i paqëndrueshëm dhe nuk bazohet në mekanizma të qëndrueshëm institucionalë.
4. Nuk ekziston një sistem i rregullt kontrolli të cilësisë dhe strukturës së faqeve zyrtare.
5. Ndërveprimi me qytetarët është i kufizuar, pasi mungojnë mekanizmat e mbledhjes së reagimit publik.
6. Aksesueshmëria dhe performanca online nuk monitorohen dhe nuk raportohen në mënyrë periodike.

MONITORIMI, VLERËSIMI DHE REAGIMI NGA PUBLIKU

Monitorimi, vlerësimi dhe reagimi nga publiku

Përmbajtja dhe rëndësia

Monitorimi dhe vlerësimi i transparencës gjyqësore përbëjnë mekanizmin thelbësor për të matur nëse gjykatat jo vetëm publikojnë informacion, por edhe sigurojnë cilësi, qartësi dhe ndikim real në perceptimin publik.

Kjo tematikë përfshin gjithashtu reagimin nga publiku dhe përdoruesit e sistemit, që është elementi më i dobët dhe më pak i zhvilluar në arkitekturën e transparencës institucionale në Shqipëri.

1. Mungesa e një mekanizmi të përhershëm monitorimi

Në praktikë, asnjë gjykatë nuk ka mekanizëm të brendshëm apo të jashtëm për monitorimin e vazhdueshëm të transparencës.

Zbatimi i programeve të transparencës vlerësohet vetëm në mënyrë formale, përmes raporteve vjetore ose verifikimeve administrative nga KLGJ.

Këto raporte zakonisht përmbajnë tregues të përgjithshëm dhe të papërditësuar, pa vlerësim cilësor të përmbajtjes apo ndikimit të informacionit të publikuar.

- Mungon një strukturë e qëndrueshme e raportimit periodik që të pasqyrojë ecurinë mujore apo tremujore të transparencës.
- Nuk ekziston një sistem krahasues (benchmark) midis gjykatave për të matur progresin dhe për të identifikuar praktikat më të mira.
- Vlerësimi mbetet i fragmentuar dhe i varur nga iniciativa individuale ose nga projekte të jashtme (p.sh. vlerësimet e donatorëve ose mediave).

2. Mungesë indikatorësh të matshëm dhe metodash të standardizuara vlerësimi

Shumica e gjykatave nuk kanë indikatorë të brendshëm për vetëvlerësim të transparencës, si p.sh.:

- sa herë përditësohen rubrikat;
- sa kërkesa për informacion janë trajtuar;
- sa njoftime janë publikuar;
- sa vizita ka faqja e internetit apo ndjekje në rrjete sociale.

Në mungesë të këtyre të dhënave, nuk mund të matet progresi apo ndikimi i transparencës në publik.

KLGJ, nga ana e vet, nuk përdor ende një format unik raportimi që t'i kërkojë çdo gjykate të dërgojë tregues sasiorë dhe cilësorë mbi komunikimin publik.

Monitorimi, vlerësimi dhe reagimi nga publiku

3. Roli pasiv i publikut dhe mungesa e mekanizmave për reagim

Publiku është ende përfitues pasiv, jo aktor pjesëmarrës në vlerësimin e transparencës. Gjykatat rrallëherë ofrojnë mundësi për reagime, pyetje, ankesa ose komente mbi përmbajtjen e publikuar. Në shumicën e faqeve zyrtare mungojnë:

- formularë online për reagim (feedback);
- rubrika "pyetje të shpeshta" (FAQ) ose sondazhe për kënaqësinë e përdoruesve;
- opsione për vlerësim të cilësisë së informacionit (p.sh. "a ishte i dobishëm ky material?").

Kjo tregon se transparenca nuk shihet ende si proces komunikimi dypalësh, por si transmetim njëdrejtimësh informacioni.Mungesa e reagimit nga publiku kufizon aftësinë e institucioneve për të përmirësuar mënyrën e komunikimit dhe për të ndërtuar besim afatgjatë.

4. Varësia nga nisma të jashtme për vlerësim

Në mungesë të mekanizmave të brendshëm, monitorimi i transparencës ka ardhur kryesisht nga jashtë nga organizata. Këto vlerësime kanë qenë të vlefshme, por jo të institucionalizuara: nuk kanë ritëm të qëndrueshëm, nuk pasohen nga plane veprimi dhe nuk përfshihen në ciklin e llogaridhënies së KLGJ-së apo vetë gjykatave.

Kjo krijon varësi nga monitorimi i jashtëm: sapo mbaron një projekt, ndërpritet edhe cikli i analizës dhe përmirësimit.

Në thelb, sistemi gjyqësor nuk ka ende "memorie institucionale" për transparencën, as mekanizma për vetë-mësim institucional nga përvojat e mëparshme.

5. Mungesë sistemi për ndarjen e praktikave pozitive

Në nivel sistemi nuk ekziston një mekanizëm i strukturuar për identifikimin, dokumentimin dhe shpërndarjen e praktikave të mira në fushën e transparencës dhe komunikimit publik.

Gjykatat operojnë kryesisht të shkëputura nga njëra-tjetra, pa platforma të përbashkëta bashkëpunimi, shkëmbimi përvojash ose trajnime të ndërsjella. Kjo mungesë koordinimi e kufizon përhapjen e modeleve efektive dhe pengon ndërtimin e një qasjeje të unifikuar dhe të qëndrueshme të transparencës në të gjithë sistemin gjyqësor.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Ndërtimi i një mekanizmi të qëndrueshëm të monitorimit kombëtar

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) duhet të krijojë një mekanizëm të përhershëm për monitorimin e transparencës, të integruar në sistemin e vet të raportimit institucional. Ky mekanizëm duhet të bazohet në tre elemente:

- Vetëvlerësim periodik nga gjykatat (p.sh. çdo 6 muaj) përmes një formati standard të unifikuar;
- Vlerësim i jashtëm periodik nga KLGJ;
- Raport publik kombëtar mbi ecurinë e transparencës gjyqësore, me renditje krahasuese dhe identifikim të praktikave më të mira.

Për këtë qëllim, KLGJ mund të institucionalizojë instrumente tashmë të zhvilluara nga shoqëria civile, si Scorecard-i i transparencës apo Pyetësori i praktikave administrative, duke i shndërruar në mekanizma të përvitshëm vlerësimi.

2. Formalizimi i vetëvlerësimit të gjykatave

Çdo gjykatë duhet të përgatisë raport vetëvlerësimi për transparencën, si pjesë të raportit të saj vjetor. Ky raport duhet të përfshijë:

- tregues sasiorë (numri i njoftimeve, kërkesave për informacion, dokumenteve të publikuara, etj.);
- tregues cilësorë (koha mesatare e përgjigjeve, cilësia e përmbajtjes, reagimi i publikut);
- analiza të sfidave dhe plan veprimi për përmirësim.

KLGJ mund të miratojë një model të unifikuar raportimi me fletë-vetëvlerësimi (self-assessment sheet), duke lehtësuar krahasimin ndër-gjykatës dhe ndjekjen e progresit në vite.

3. Përdorimi i teknologjisë për raportim dhe analizë automatike

Rekomandohet zhvillimi i një platforme digjitale të përbashkët për transparencën gjyqësore, ku:

- çdo gjykatë të ngarkojë periodikisht të dhënat e veta;
- sistemi të gjenerojë automatikisht grafikë dhe analiza për KLGJ-në;
- të mundësohet publikimi i përmbledhjeve vizuale (dashboards) për publikun.

Ky model do të reduktonte barrën administrative, do të siguronte vazhdimësi të të dhënave dhe do të lejonte monitorim në kohë reale të përditësimeve në faqet e gjykatave.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Krijimi i mekanizmave të reagimit publik

Për të bërë transparencën të matshme dhe përfshirëse, çdo gjykatë duhet të integrojë forma të rregullta reagimi (feedback-u) nga qytetarët dhe përdoruesit e sistemit. Opsionet mund të përfshijnë:

- formular online "Shpreh mendimin tuaj" ose "Vlerësoni shërbimin tonë";
- rubrikë me pyetje të shpeshta (FAQ) dhe sondazhe të thjeshta për përdoruesit;
- kuti fizike dhe digjitale për komente e sugjerime;
- analiza vjetore të reagimit, me publikim të rezultateve dhe masave të marra.

Ky komponent e kthen publikun në aktor bashkëvlerësues, duke ndihmuar gjykatat të kuptojnë nevojat reale të qytetarëve dhe të përmirësojnë komunikimin.

5. Përfshirja e shoqërisë civile dhe mediave në ciklin e vlerësimit

Shoqëria civile, institucionet akademike dhe mediat mund të luajnë rol plotësues në monitorim, përmes:

- vëzhgimeve periodike të transparencës online;
- publikimeve të përbashkëta me KLGJ-në mbi ecurinë e hapjes së gjykatave;
- forumeve vjetore të transparencës, ku prezantohen rezultatet dhe praktikat më të mira.

Kjo qasje bashkëpunuese krijon legjitimitet publik për procesin dhe e bën transparencën më të besueshme.

6. Ndërlidhja me procesin e trajnimeve

Rezultatet e monitorimit duhet të ushqejnë politikat e trajnimit dhe zhvillimit profesional të stafit. Nëse identifikohen dobësi të përsëritura (p.sh. komunikim me median, publikim dokumentesh, menaxhim IT), ato duhet të përfshihen në kurrikulat e trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës apo vetë KLGJ-ja.

7. Krijimi i një "cikli të mbyllur përmirësimi"

Manuali rekomandon që transparenca të trajtohet si proces ciklik, jo si ushtrim i njëhershëm. Cikli duhet të përbëhet nga katër faza:

- Matja: mbledhja e të dhënave dhe vetëvlerësimi;
- Analiza: interpretimi i rezultateve dhe identifikimi i boshllëqeve;
- Veprimi: zbatimi i masave për përmirësim;
- Reagimi publik: përfshirja e reagimeve të qytetarëve dhe publikimi i përmirësimeve.

Kjo qasje e mbyllur siguron përmirësim të vazhdueshëm institucional dhe e bën transparencën pjesë të identitetit organizativ të gjykatave.

Përmbledhje: Monitorimi, vlerësimi dhe reagimi nga publiku

1. Transparenca gjyqësore nuk monitorohet në mënyrë të qëndrueshme dhe mungon një mekanizëm matës.
2. Nuk përdoren indikatorë standardë, duke e bërë të pamundur krahasimin dhe vlerësimin e progresit.
3. Publiku nuk ka kanale funksionale për reagim dhe mbetet jashtë procesit të vlerësimit.
4. Monitorimi aktual varet nga nisma të jashtme dhe nuk është i institucionalizuar.
5. Praktikat pozitive nuk shpërndahen dhe mungon një mekanizëm koordinimi ndërgjykata.
6. Transparenca duhet të funksionojë në një cikël të mbyllur matjeje, analize dhe përmirësimi të vazhdueshëm.

PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE ZBATIMI NË PRAKTIKË

Programi i transparencës dhe zbatimi në praktikë

Përmbajtja dhe rëndësia

Programi i transparencës përbën një nga mjetet kryesore për garantimin e llogaridhënies publike të gjykatave dhe për zbatimin në praktikë të parimeve të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në aspektin formal, të gjitha gjykatat në Shqipëri kanë hartuar dhe publikuar programet e tyre të transparencës. Megjithatë, analiza e përmbajtjes dhe zbatimit praktik tregon se përputhshmëria me standardet mbetet kryesisht formale dhe jo funksionale, duke u kufizuar në publikimin e dokumenteve bazë pa garantuar cilësi, përditësim apo përdorueshmëri të plotë.

1. Karakteri formal dhe jo funksional i shumë programeve

Një pjesë e konsiderueshme e gjykatave publikojnë programe të transparencës që nuk pasqyrojnë veçoritë reale të institucionit, por përbëjnë kopje të modeleve të unifikuara pa përshtatje sipas nevojave dhe specifikave. Në shumë raste, rubrikat ligjërimisht të detyrueshme (si "Funksionet e gjykatës", "Struktura organizative", "Buxheti", "Raporti vjetor") janë të mbushura me përshkrime të përgjithshme ose dokumente të pazbatueshme praktikisht. Kjo ka sjellë që programet të kenë funksion më shumë deklarativ sesa operacional, duke mos reflektuar dinamikën reale të punës apo veprimtarisë administrative të gjykatave.

2. Mospërputhje dhe mospërditësim i përmbajtjes

Analiza e kryer mbi faqet zyrtare të gjykatave tregon mospërputhje të theksuara në përmbajtjen e rubrikave: disa gjykata publikojnë dokumente të plota (vendime, plane buxhetore, raporte vjetore), ndërsa të tjera ruajnë boshllëqe të dukshme në seksione kyçe si raportet e auditimit, kontratat e prokurimeve apo raportet e zbatimit të buxhetit. Në disa raste, dokumentet janë të vjetra dhe nuk janë zëvendësuar me versionet e reja, duke treguar mungesë të mekanizmave të rregullt të përditësimit. Ky problem buron shpesh nga mungesa e koordinimit midis koordinatorëve të transparencës, kancelarëve dhe sektorit të IT-së, si dhe nga mungesa e qartësisë për përgjegjësitë konkrete në mirëmbajtjen e programit.

3. Mungesa e qartësisë për dokumentet reale që duhet të publikohen

Në shumë gjykata ekziston paqartësi e konsiderueshme në lidhje me llojin dhe nivelin e detajit të informacionit që duhet të publikohet. Disa institucione publikojnë vetëm përshkrime të përgjithshme (p.sh. "vendimet janë të aksesueshme në gjykatë"), ndërsa të tjera publikojnë dokumente të plota PDF pa kontekst apo shpjegime. Mungesa e standardeve të unifikuara në zbatimin e programit bën që qasja e qytetarëve ndaj informacionit të jetë e pabarabartë, duke cënuar transparencën reale dhe barazinë institucionale në raport me publikun.

Programi i transparencës dhe zbatimi në praktikë

4. Paqartësi në raportin midis transparencës aktive dhe asaj pasive

Megjithëse programi synon të garantojë transparencë aktive përmes publikimit proaktiv të informacionit, praktika tregon se në shumë raste ai funksionon si mjet reagimi ndaj kërkesave të qytetarëve. Kjo qasje reaktive, që vjen si pasojë e ngarkesës së stafit dhe mungesës së një kulture të konsoliduar në këtë drejtim, ka bërë që transparenca aktive të mbetet dytësore, duke e kufizuar publikimin në informacion minimalisht të detyrueshëm ligjërisht.

5. Mungesë monitorimi dhe përgjegjshmërie për zbatimin e programit

Aktualisht nuk ekziston një mekanizëm funksional për monitorimin periodik të zbatimit të programeve të transparencës nga gjykatat. Në mungesë të raporteve vlerësuese apo kontrolleve të rregullta, programet mbeten dokumente të publikuara formalisht, pa një proces të qartë vetëvlerësimi apo rregullimi në rast mospërmbushjeje. Kjo ka sjellë që nivelet e transparencës të varen kryesisht nga vullneti i brendshëm i drejtuesve të gjykatave, duke krijuar dallime të theksuara ndërmjet institucioneve të të njëjtit nivel.

6. Zbatimi standard por me ndryshime në cilësinë e përmbajtjes

Të gjitha gjykatat zbatojnë modelin standard të Programit të Transparencës, në përputhje me strukturën e miratuar dhe në respekt të kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Megjithatë, analiza tregon se niveli i zbatimit praktik ndryshon ndjeshëm nga një gjykatë në tjetrën. Ndërsa formati dhe rubrikat janë të njëjta, cilësia e përmbajtjes së publikuar, përditësimi, qartësia dhe lehtësia e aksesit mbeten elementet që dallojnë gjykatat më të avancuara nga ato me transparencë minimale. Kjo tregon se sfida kryesore nuk është më standardizimi formal, por konkretizimi i përmbajtjes dhe menaxhimi i vazhdueshëm i informacionit në mënyrë të plotë dhe të besueshme.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Trajtimi i programit si instrument dinamik dhe i menaxhuar në mënyrë aktive

Për të shmangur formalizmin dhe për ta kthyer programin e transparencës në një instrument funksional, gjykatat duhet ta konsiderojnë atë dokument dinamik, i cili përditësohet në mënyrë periodike dhe reflekton ndryshimet aktuale të institucionit.

Udhëzimet kryesore janë:

- Planifikimi i përditësimeve mujore ose tremujore për rubrikat që ndryshojnë më shpesh (prokurime, vendime, buxhet, njoftime).
- Vendosja e një përgjegjësi të qartë administrative për koordinimin e përmbajtjes (p.sh. koordinatori për të drejtën e informimit në bashkëpunim me kancelarin dhe IT-në).
- Përfshirja e programit në procesin e planifikimit institucional, në mënyrë që përditësimi të jetë pjesë e kalendarit të rregullt të punës.

2. Përmirësimi i cilësisë së përmbajtjes dhe gjuhës së komunikimit

Përmbajtja e programit duhet të jetë e kuptueshme, e përditësuar dhe e orientuar drejt publikut. Zbatimi i standardeve kërkon:

- Shmangien e gjuhës teknike ose burokratike dhe përdorimin e gjuhës së thjeshtë administrative për çdo rubrikë (p.sh. përkthimi i termave buxhetorë apo statistikave në forma të kuptueshme për qytetarin).
- Shtimin e përshkrimeve shpjeguese për çdo dokument të publikuar, që lexuesi të kuptojë funksionin e tij.
- Rishikimin periodik të përmbajtjes për të garantuar qartësi dhe besueshmëri.

3. Përcaktimi i mekanizmave të brendshëm për menaxhimin e transparencës

Efektiviteti i programit varet nga organizimi i brendshëm. Për këtë qëllim rekomandohet:

- Krijimi i një grupi pune ndërsektorial (koordinatori i informimit, IT, kancelari, juristi, PR-i), që të mbikëqyrë zbatimin e programit dhe të raportojë çdo gjashtë muaj te KLGJ.
- Hartimi i një plani të thjeshtë të punës për transparencën (me afate, përgjegjës, objektiva dhe tregues për përditësim).
- Mbajtja e një regjistri të brendshëm të përditësimeve, për të siguruar gjurmueshmëri dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e faqes.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

4. Integrimi i programit me komunikimin publik dhe median

Për të rritur efektin praktik të transparencës, programi duhet të lidhet ngushtë me komunikimin proaktiv të gjykatës. Në këtë kuadër:

- Rubrika "Programi i transparencës" duhet të ndërthuret me seksionet e njoftimeve, raportimeve dhe materialeve për media, për të krijuar një pamje të unifikuar dhe koherente për publikun.
- Çdo përditësim i rëndësishëm duhet të shoqërohet me njoftim publik të shkurtër, duke informuar qytetarët për dokumentet e reja, ndryshimet apo raportet e publikuara.
- Stafi përgjegjës për komunikimin duhet të trajnohet për të përdorur programin jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe si instrument edukimi dhe ndërveprimi me publikun.

5. Trajnimi dhe ndërtimi i kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm

Qëndrueshmëria e programeve të transparencës varet nga aftësitë profesionale dhe kultura institucionale e hapjes. Për këtë arsye rekomandohet:

- Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta për koordinatorët e transparencës, sektorin IT dhe zyrtarët e komunikimit publik, me fokus në standardet e transparencës dhe administrimin e përmbajtjes.
- Ndarja e praktikave pozitive ndërmjet gjykatave përmes takimeve tematike dhe forumeve, për të nxitur harmonizim dhe mësim të ndërsjellë.
- Promovimi i një qasjeje reflektuese, ku transparenca trajtohet si proces i përmirësimit të vazhdueshëm dhe jo thjesht si listë detyrimesh formale.

Përmbledhje: Programi i transparencës dhe zbatimi në praktikë

1. Programet e transparencës mbeten kryesisht formale dhe nuk funksionojnë si mjete praktike informimi.
2. Përmbajtja është shpesh e papërditësuar dhe e pastrukturuar, duke krijuar pabarazi në aksesin e publikut.
3. Gjykatat kanë paqartësi mbi dokumentet dhe nivelin e detajit që duhet të publikojnë.
4. Transparenca aktive mbetet e dobët, pasi publikimi bëhet kryesisht si reagim ndaj kërkesave.
5. Mungon monitorim i rregullt dhe përgjegjshmëri për zbatimin e programeve.
6. Zbatimi formal i modelit standard fsheh diferenca të mëdha në cilësinë e përmbajtjes dhe përdorueshmërinë e saj.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONALITETI I FAQES ZYRTARE TË GJYKATËS

Organizimi dhe funksionaliteti i faqes zyrtare të gjykatës

Përmbajtja dhe rëndësia

Faqja zyrtare e gjykatës është instrumenti kryesor për zbatimin praktik të transparencës gjyqësore dhe për ndërveprimin me publikun. Ajo shërben si dritare institucionale, ku qytetarët, mediat dhe palët e interesuara informohen mbi veprimtarinë, vendimmarrjet dhe shërbimet publike të gjykatës. Megjithëse të gjitha gjykatat në Shqipëri kanë tashmë faqe funksionale të ndërtuara mbi modelin e unifikuar të miratuar nga KLGJ, analizat tregojnë se niveli i cilësisë, përmbajtjes dhe funksionalitetit ndryshon ndjeshëm ndërmjet institucioneve.

1. Strukturë e unifikuar, por përdorim jo uniform i rubrikave

Korniza standarde e faqes zyrtare e ndarë në rubrika si Programi i Transparencës, Njoftime, Vendime, Prokurime, Buxheti, Kontaktet, Statistikat, Media, etj. zbatohet formalisht nga të gjitha gjykatat. Megjithatë, cilësia e plotësimit të këtyre rubrikave ndryshon ndjeshëm. Disa gjykata i kanë faqet të strukturuara mirë, me dokumente të përditësuara dhe të lehta për t'u gjetur; të tjera ruajnë boshllëqe ose rubrika të paaktivizuara. Më problematike rezultojnë rubrikat që kërkojnë publikime periodike, si Raportet vjetore, Prokurimet publike dhe Statistikat gjyqësore, të cilat shpesh nuk përditësohen.

2. Mungesë hierarkie të qartë në organizimin e informacionit

Struktura e brendshme e faqeve shpesh nuk ndjek logjikë të qartë hierarkike, duke e vështirësuar orientimin e përdoruesit. Në disa raste, dokumentet janë të shpërndara në rubrika të ndryshme (p.sh. vendimet gjenden si "njoftime" ose "pasqyra shtypi"), ndërsa ndonjëherë rubrika të rëndësishme mungojnë fare në menynë kryesore. Mungesa e një standardi për renditjen e rubrikave dhe për mënyrën e paraqitjes së dokumenteve krijon pabarazi ndërmjet faqeve dhe ul efikasitetin e aksesit publik.

3. Aksesueshmëri dhe orientimi në faqe i kufizuar

Në shumë faqe nuk janë parashikuar mjete praktike për kërkim të brendshëm, filtra apo tabela interaktive. Një pjesë e dokumenteve publikohen si PDF pa linke të brendshme, pa datë, apo pa mundësi kërkimi të drejtpërdrejtë. Në disa raste mungon informacioni për aftësitë e aksesit universal (p.sh. për përdoruesit me aftësi të kufizuara ose për pajisje celulare). Kjo e bën navigimin më shumë formal se funksional, duke kufizuar ndjeshëm përdorueshmërinë e faqes si mjet informimi publik.

Organizimi dhe funksionaliteti i faqes zyrtare të gjykatës

4. Mungesë koherence vizuale dhe standardi estetik

Pavarësisht se modeli bazë është unik, në praktikë faqet paraqiten me stile, ngjyra dhe formatime të ndryshme, çka krijon përshtypjen e mungesës së identitetit të unifikuar të sistemit gjyqësor. Në disa raste logoja, ngjyrat institucionale ose renditja vizuale e përmbajtjes nuk janë të përshtatura me modelin grafik të përcaktuar. Kjo mospërputhje vizuale ul perceptimin e profesionalizmit dhe seriozitetit institucional në publik.

5. Mospërputhje ndërmjet përmbajtjes dhe strukturës ligjore

Megjithëse struktura e faqes është ndërtuar mbi standardin ligjor të transparencës, përmbajtja reale nuk pasqyron gjithmonë përmbajtjen e detyrueshme të programit të transparencës. P.sh., rubrikat Buxheti dhe Auditimi shpesh nuk përmbajnë të dhëna të plota, ndërsa Raportet vjetore nuk janë të përditësuara për çdo vit. Në disa raste, rubrika "Të dhënat e hapura" ekziston formalisht, por pa asnjë dokument të ngarkuar. Kjo tregon se zbatimi është më shumë teknik sesa përmbajtësor, dhe mungon kontrolli periodik i cilësisë së informacionit të publikuar.

6. Mungesë integrimi me mjetet e tjera të komunikimit institucional

Në pjesën më të madhe të gjykatave, faqja zyrtare nuk lidhet me kanalet e tjera të komunikimit publik (si rrjetet sociale ose njoftimet për median). Kjo e bën faqen një platformë të mbyllur dhe jo një hapësirë dinamike komunikimi. Në praktikë, informacioni shpesh qarkullon përmes mediave apo burimeve të treta, duke e lënë gjykatën pasive në menaxhimin e imazhit dhe informacionit publik.

7. Nevoja për monitorim të përbashkët dhe mirëmbajtje të centralizuar

Megjithëse modelet janë të standardizuara, mungon një sistem i përbashkët monitorimi dhe mirëmbajtjeje teknike nga KLGJ. Aktualisht, përditësimi varet nga vetë gjykatat, pa një mekanizëm të centralizuar kontrolli për përmbajtjen, sigurinë e të dhënave ose versionet e faqes. Një sistem i tillë qendror do të mundësonte ruajtjen e koherencës, sigurisë dhe cilësisë teknike, si dhe do të lehtësonte mbështetjen teknologjike të gjykatave me kapacitete të kufizuara.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

1. Strukturë e unifikuar dhe e qëndrueshme në të gjitha gjykatat

- Të gjitha faqet zyrtare duhet të ndjekin strukturën standarde duke ruajtur një hierarki të qartë rubrikash dhe nënrubrikash sipas modelit:
- Rreth Gjykatës – Struktura – Programi i Transparencës – Njoftime – Vendime – Prokurime – Raporte vjetore – Statistika – Kontaktet – Media & Publikime.
- Në çdo gjykatë, renditja dhe formatimi i rubrikave duhet të jenë të njëjta në emërtim dhe logjikë për të garantuar uniformitet institucional dhe lehtësi navigimi për qytetarët.
- KLGJ mund të ofrojë template të përbashkëta digjitale për secilën rubrikë, me përmbajtje bazë dhe hapësira të përshtatshme për shtimin e dokumenteve specifike sipas gjykatës.

2. Përditësimi dhe mirëmbajtja periodike

- Çdo gjykatë duhet të ketë një plan përditësimi periodik (mujor ose tremujor), me përgjegjësi të qarta institucionale për administrimin e faqes.
- Rubrikat që përmbajnë informacion dinamik (njoftime, vendime, prokurime, statistika) duhet të përditësohen në kohë të arsyeshme dhe brenda afateve të përcaktuara nga rregullat e brendshme.
- Duhet të funksionojë një mekanizëm i brendshëm verifikimi, që kontrollon saktësinë dhe azhurnimin e dokumenteve të publikuara.

3. Aksesueshmëria dhe lehtësia e përdorimit

- Faqet duhet të jenë të aksesueshme në të gjitha pajisjet (desktop, tablet, celular) dhe të ofrojnë përkthim në anglisht për informacionet bazë institucionale.
- Duhet të sigurohet akses për personat me aftësi të kufizuara (kontrast i rregullueshëm, alt-tekste, navigim përmes tastierës).
- Të përfshihet një motor kërkimi i brendshëm që lejon filtrimin e dokumenteve sipas datës, fjalëkyçeve ose kategorive.
- Dokumentet duhet të kenë titull të qartë, datë, format dhe përshkrim të shkurtër përmbajtësor.

4. Cilësia e përmbajtjes dhe gjuha e komunikimit

- Përmbajtja duhet të jetë e saktë, e kuptueshme dhe e orientuar drejt publikut të gjerë, jo vetëm profesionistëve të drejtësisë.
- Duhet shmangur terminologjia e tepërt teknike, duke përdorur përshkrime shpjeguese dhe gjuhë administrative të qartë.
- Publikimet duhet të jenë të strukturuara, të plota dhe të respektojnë standardet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

Udhëzime dhe zgjidhje orientuese

5. Integrimi i elementëve multimedialë dhe ndërveprues

- Rubrika multimediale duhet të jetë funksionale dhe të përfshijë video informuese, foto zyrtare dhe materiale udhëzuese për publikun.
- Përdorimi i videove shpjeguese (p.sh. për procedurat gjyqësore, tarifat, ngritjen e padisë) rrit aksesin dhe kuptueshmërinë e informacionit.
- Duhet të ofrohet një hartë interaktive e juridiksionit dhe një formular kontakti online për pyetje apo kërkesa për informacion.

6. Klasifikimi korrekt i dokumenteve dhe njoftimeve

- Të respektohet ndarja e qartë ndërmjet:
  - Njoftimeve për publikun (njoftime për seanca, orare, nisma, vend pune);
  - Publikimeve institucionale (raporte, statistika, udhëzime, buletine);
  - dhe Vendimeve të Këshillit të Gjykatës (procesverbale, vendimmarrje).
- Dokumentet me karakter afatshkurtër (shortet, kalendarët, shpalljet) duhet të vendosen në rubrikat operative dhe jo në “Publikime”, për të shmangur mbingarkesën e faqes.

7. Koherencë vizuale dhe identitet institucional

- Faqet duhet të ndjekin një identitet vizual të unifikuar (logo, ngjyra, tipografi, strukturë).
- Faqet duhet të përdorin elemente grafike dhe formatim standard, për të krijuar perceptimin e një sistemi të bashkërenduar dhe profesional.
- Çdo përditësim grafik ose teknologjik duhet të koordinohet për të siguruar uniformitet dhe siguri teknike.

8. Menaxhimi teknik dhe siguria e të dhënave

- Faqet duhet të administrohen nga persona të trajnuar dhe të kenë protokolle të qarta për qasjen administrative.
- Duhet të sigurohet enkriptim i faqes (https), kopje rezervë automatike, log-e sigurie dhe mbrojtje ndaj sulmeve kibernetike.
- Mund të funksionojë një shërbim i përbashkët teknik për mirëmbajtjen, hostimin dhe sigurinë digjitale të të gjitha faqeve gjyqësore.

9. Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm

- Çdo gjykatë duhet të raportojë periodikisht mbi përditësimet, përdorimin e faqes dhe indikatorë të transparencës digjitale.
- Duhet të zhvillohen mekanizma vlerësimi që matin cilësinë, përditësimin dhe përdorueshmërinë e faqeve, për të garantuar përmirësim të vazhdueshëm.
- Auditimet vjetore ose analizat krahasuese ndërmjet gjykatave ndihmojnë në identifikimin e boshllëqeve dhe praktikave më të mira.

Përmbledhje: Organizimi dhe funksionaliteti i faqes zyrtare të gjykatës

1. Faqet zyrtare të gjykatave duhet të ndjekin një strukturë të unifikuar dhe të qëndrueshme.
2. Përditësimi periodik dhe menaxhimi aktiv i përmbajtjes janë thelbësorë për transparencën.
3. Aksesueshmëria dhe orientimi në faqe rritin përdorueshmërinë dhe besueshmërinë publike.
4. Përmbajtja duhet të jetë e qartë, e kuptueshme dhe e orientuar drejt publikut.
5. Elementët multimedialë dhe mjetet ndërvepruese e modernizojnë komunikimin institucional.
6. Monitorimi i vazhdueshëm teknik dhe përmbajtësor garanton cilësi dhe përmirësim afatgjatë.

Ky Manuali përfaqëson një instrument mbështetës për institucionet gjyqësore, i ndërtuar me qëllimin për të ofruar udhëzime të qarta dhe të standardizuara mbi mënyrën e publikimit, komunikimit dhe administrimit të informacionit publik. Dokumenti synon të forcojë kulturën komunikimit publik, qartësisë dhe llogaridhënies në çdo nivel institucional, duke e orientuar sistemin drejt praktikave moderne të transparencës dhe shërbimeve të aksesueshme për qytetarët. Ai shërben si referencë praktike për rritjen e cilësisë së informacionit, përmirësimin e ndërveprimit me publikun dhe konsolidimin e një standardi të përbashkët që mbështet integritetin dhe besueshmërinë e sistemit gjyqësor.

Informacion Kontakti

+355 4 562 8607

www.csdgalbania.org

Adresa: Rruga Ymer Kurti, Tiranë 1060